1) Join the pairs of the sentences according to this pattern: a) *Ai deshi të lahej (He wanted to be washed).* b) *Ai shkoi në banjë (He went to the bathroom): Ai shkoi në banjë që të lahej (He went to the bathroom so as to be washed).* Use the following phrases: **me qëllim që, në mënyrë që për të, që të** (so as to or so that). - 1. *Ata dëshën të shkonin atje me të shpejtë. Ata shkuan me shpejtë.* - 2. *E sëmura deshi që të hapte dritën pa u ngritur nga shtrati. Ata vendosën një çelës pranë shtratit.* - 3. *Unë desha të punoja. Mbylla derën.* - 4. *Ai mbante librin lart. Ai deshi që secili ta shihte.*

2) Translate into English: 1. *Ai i hoqi këpucët.* - 2. *Mjeku më tha se unë nuk kam gjë (nuk kam asgjë të keqe, d.m.th., se jam mirë, se gjendja ime shëndetësore është fare e mirë).*

3. *Do të ishte mirë sikur ti të çoheshe herët nesër në mëngjes.* - 4. *Kam shumë uri! (or Unë jam shumë i uritur!)* - 5. *Do të shohim si do të ndihesh nesër.* - 6. *A kanë vendosur ata se ç'do të bëjnë?* - 7. *Më duket se ata po flisin për (about) tregtinë e jashtme (foreign trade).* - 8. *Po, ti je plotësisht të drejtë, ta them unë.* - 9. *A je dakord me mua?* - 10. *Përse e kanë vënë kutinë e siguresave poshtë në qilar, apo që kështu të mos mund ta gjejmë pa dritë?*

Lesson 43 / Mësimi dyzet e tre
Forty-third Lesson / Mësimi i dyzetetretë
Vocabulary / Fjalorth

botë - world

flotë metal; llamarinë - metal sheet

grup timóni - steering (wheel)

i cili, të cilin, të cilët; e cila, të cilën,
të cilat - which; that

i (e, të) plotë - complete

i (të) ngjashëm, një lloj; i një lloji - alike

i (e, të) vet - own

i (të) zhurmshëm, me zhurmë - noisy

i (e, të) shtrenjtë - expensive

i (e, të) tërë; i, e, të gjithë - whole

i (e, të) lirë - cheap

i (e, të) lirë, me çmim të ulët - cheap,
 cheaply

që - that; which

quhet, i quajtur - called

kamion - truck

karrocëri - body

kënd - angle

kënd, qoshe, cep - corner, edge

kompani, shoqëri - firm, company

linjë montimi - assembly-line

makinë - machine (a press machine)

më i zhurmshmi - (the) noisiest

ndaj, pjesëtó - (to) divide

postoj - (to) post

presë, stampë - press

presó, stampoj - (to) press

prodhim - product

prodhime në seri, prodhime masive
 mass-production

repárt - department

secili, çdonjëri - each

shasi - chassis

traktór - tractor

Relative pronouns in attributive clauses

The attributive clause changes or limits the meaning of the noun, the subject or the object of the main clause.

I cili, të cilin (masculine, singular), **të cilët** (masculine, plural), **e cila, të cilën** (feminine singular), **të cilat** (feminine, plural) and **që** (masculine and feminine, singular and plural), are relative pronouns. They are used to show inanimate objects.

The relative pronoun **që** may be replaced by **i cili, të cilin, të cilët, e cila, të cilën, të cilat** (which, that). Examples:

Shtëpia që është në qoshe të rrugës ... or **Shtëpia e cila është në qoshe të rrugës ...**
 The house that is at the corner of the street ...

Që, has a limiting function, it plays the role of an attribute. If the English relative pronoun *that* (**që, i cili, e cila, të cilët, të cilat**), plays the role of an object, it may be omitted but not if it is a subject. This doesn't happen in Albanian. Examples:

The attributive clause **që është ...**, is used to qualify, individualize and specify the noun **shtëpia** (the house), **libri** (the book). Examples:

Shtëpia që keni në qoshen e rrugës ...

The house (that) you have at the corner of the street ...

Libri që ju më huajtët javën e kaluar (object).

The book (that) you lent me last week.

I cili, të cilin, të cilët, e cila, të cilën and të cilat (which), if used in attributive clauses, are generally separated by a comma from the main clauses. These ones are used with or without prepositions.

If **që** is playing the function of the subject and the object of the verb, then it is used without a preposition. For this, see also lesson 13. Examples:

Kjo është vetura me të cilën do të udhëtojmë ne.

This is the car which we will travel with.

or **Ajo është vetura që do të udhëtojmë ne.**

That is the car which we will travel with.

Ky është lapsi me të cilin unë do të shkruaj një letër.

This is the pen that I will write a letter with.

or **Ky është lapsi që unë do të shkruaj një letër.**

This is the pen (that) I will write a letter with.

Fotografia që ju po shihnit.

The photo at which you were looking.

or **Fotografia të cilën ju po shihnit.**

The photo which you were looking at.

Unë kam një orë e cila tregon ditët e muajit.

or **Unë kam një orë që tregon ditët e muajit.**

I have a watch that tells the days of the month.

Table no. 69 (The declension of relative pronoun **i cili, e cila, etc.**)

Masculine			Feminine	
Case	Singular	Plural	Singular	Plural
Nominative	i cili	të cilët	e cila	të cilat
Genitive	i (e) të cilit	i (e) të cilëve	i (e) së cilës	i (e) të cilave
Dative	të cilit	të cilëve	së cilës	të cilave
Accusative	të cilin	të cilët	të cilën	të cilat
Ablative	prej të cilit	prej të cilëve	prej së cilës	prej të cilave

The attributive clauses of place begin with the adverb of place **ku** (*where*). The attributive clauses of time, begin with **kur** (*when*). See the following examples:

Fabrika ku (në të cilën) unë punoj The factory where I work
Më kujtohet dita kur (në të cilën) ju pashë për herë të parë.
I remember the day when I saw you first.

Kështjella e Beratit, Shqipëri.
 The castle of Berat, Albania.



Conversation (Track 44)

- Doroti:** Z. Benedíkt, na trego tani mbi uzínën ku ti punon.
- Xhoni:** A do të dëshironit me të vërtetë ta díní? ¹⁾
- Iliri:** Po, le të dëgjojmë për të. ²⁾
- Xhoni:** Epó, siç e díní, firma për të cilën punoj unë, prodhón autovetúra. Por ne prodhojmë gjithashtu kamionë dhe traktorë; por autoveturat janë prodhími ynë kryesor.
- Iliri:** Dhe autoveturat që prodhóni ju - a janë shumë të shtrénjta?
- Xhoni:** Jo, ato janë të një lloji që duken të shtrénjta, por që në të vërtetë janë të líra. Është prodhími në serí që e bën këtë të mundshme.
- Doroti:** Do të thúash, ju prodhóni qíndra vetúra të gjitha njësoj?
- Xhoni:** Po, dhe kështu ne mund t'i prodhójmë ató lirë. Ne e ndajmë të gjithë uzínën në reparte dhe secili repart ka púnën e vet të posaçme. ³⁾
- Ka një repart që ndërtón shasítë, një tjetër që bën sistémín e drejtímit, dhe kështu me radhë. Dhe pastaj është línja kryesóre e montímit.
- Doroti:** Ç'është ajo? ⁴⁾
- Xhoni:** Oh, ajo është véndi ku të gjitha pjesët bashkóhen për të bërë një veturë të plotë.
- Iliri:** Dhe repartí júaj?
- Xhoni:** Repartí të cílin drejtoj unë ⁵⁾ quhet repartí i presímit. ⁶⁾ Aí është plot me makinerí të mëdha që stampójnë flétën e llamarínës për kabínat e autoveturave. ⁷⁾
- Doroti:** A është aí shumë i zhurmshëm?
- Xhoni:** I zhurmshëm! Është véndi më i zhurmshëm në botë!

Explanations: 1) A do të dëshironit me të vërtetë ta díní? - *Would you really like to know it?* - 2) le të dëgjojmë për të; pa le të dëgjojmë për të - *let's hear about it.* - 3) punën e vet të posaçme (të veçantë) - *its special job.* - 4) Ç'është ajo? - *What's that?* - 5) Repartí që

Lesson 43 / Mësimi dyzet e tre

drejtoj unë; Reparti të cilin drejtoj unë - *The department I run.* - 6) Reparti i presimit; reparti i presave; reparti i stampimit - *the press shop.* - 7) Stampon (preson) fletën e llamarinës për kabinat (karrocëritë e veturave) - *press out the sheet metal for the bodies of the cars.*

Reading exercises

1. Gazetë, lexoj: Gazeta që unë lexoj është shumë e mirë: Gazetë, lexoj: Gazeta që unë lexoj është shumë e mirë. - Restorant, ha: Restoranti në të cilin unë ha është shumë i mirë. - Veturë, ngas veturën: Vetura që unë drejtoj është shumë e mirë. - Ushqim, ha: Ushqimi që ha unë, është shumë i mirë. - Birrë, pi: Birra që unë pi, është shumë e mirë.

2. Uzinë, punoj: Kjo është uzina ku unë punoj: Uzinë, punoj: Kjo është uzina ku unë punoj. - Dhomë, fle: Kjo është dhoma ku unë fle. - Qytet, banoj: Ky është qyteti ku unë banoj. - Restorant, ha: Ky është restoranti ku unë ha. - Hotel, qëndroj: Ky është hoteli ku unë qëndroj.

3. Ata kanë blerë një shtëpi. Ata do të na tregojnë shtëpinë që kanë blerë. - Ai ka shkruar një libër. Ai do të na tregojë librin që ka shkruar. - Ai dëshiron një motoçikletë. Ai do të na tregojë motoçikletën që dëshiron. - Ata shkojnë në kishë. Ata do të na tregojnë kishën në të cilën shkojnë. - Ajo do të blejë një fund. Ajo do të na tregojë fundin që dëshiron të blejë.

Sentences and phrases for lessons 42 and 43

Ulu pranë mëje që unë të mund të shoh se çfarë po bën.

Sit down beside me, so that I can see what you're doing.

Pastaj unë mund të ta tregoj si ta bësh.

Then I can show you how to do it.

Ai qëndroi pranë dritares për të parë se çfarë po ndodhte jashtë.

He stood near the window, so as to see what was happening outside.

Të lutem hapë radion që të dëgjojmë lajmet.

Please turn on the radio, so that we can hear the news.

Çfarë ke bërë me atë letrën që të dhësh për të postuar?

What have you done with that letter I gave you to post?

Ai ka gjetur punë në një fabrikë e cila bënë vetura.

He's got a job in a factory that makes cars.

Ai është në repartin që ndërtón shasitë.

He's in the department that builds the chassis.

Reparti ku unë punoj quhet sektori i stampimit.

The department where I work is called the press shop.

Sa kushtonte vetura që po shihnim dje?

How much did that car we were looking at yesterday cost?

Practice exercises

1) From the conversation of this lesson try to show: 1. Five sentences where që (that) is used as a subject. - 2. Two sentences containing the adverb of place ku (where).

2) Translate into English: 1. Si e ka emrin klubi që i bën mbledhjet në këtë sallë?
- 2. A nuk është ky lloji i muzikës që të pëlqen? - 3. Kemi marrë përgjigje nga të gjitha firmat të cilave u kemi dërguar letër.- 4. A është kjo kutia ku ti mban dokumentet (*papers, records*)e mia?
- 5. Ai nuk dëshiron një orë që nuk tregon orën e saktë.- 6. Kur do të shkojmë ne të shohim atë veturën e mrekullueshme për të cilën na fole? - 7. Kinemaja dhe jo radioja i pëlqen me të vërtetë atij.- 8. Po shkojmë në një vend të vogël e të qetë që e di unë.- 9. Duhet t'i harrosh të gjitha librat që ke lexuar dhe të gjitha pikturat që ke parë. - 10. A është kjo shtëpia ku banon Z. Begu?

3) Translate into Albanian: Many modern car factories produce trucks and tractors. - But cars are their main product.- They are cheap, but they look nice. - This is possible because of mass-production. - Factories are divided into many departments. - Each department has its own special job. - One builds the chassis, and another makes the steering. - Finally, there is the assembly-line, where all parts are put together. - It's here where all the nice cars are produced. the cars we see in the streets of our town that help you go within a few minutes to towns which are many kilometers away.

Lesson 44 / Mësimi dyzet e katër
 Forty-fourth Lesson / Mësimi i dyzetekatërt
 Vocabulary / Fjalorth

çështje - *affair*
 dëgjoj - *(to) hear, (to) listen*
 djalë, djalósh - *chap, lad*
 infermière - *nurse*
 rregullisht - *regularly*
 i (e, të) ménçur; i aftë - *smart, able*
 i (e, të) rrëgullt - *regular*
 i (të) zakónshëm - *common*
 mjekoj, kurój - *(to) cure*
 môtër (in a hospital) - *sister*
 paciéntë të jashtëm (ambulatorë) -
out-patients
 paciént i shtruar në spítal - *inpatient*
 person, njeri - *person*
 postíer - *postman*
 pothuaj, pothuajse - *almost, nearly*

punonjës i asistencës sociale - *social*
worker
 punonjës social - *social worker*
 repart ambulator - *outpatients'*
department; ward, pavilion;
surgery (same - day surgery)
 sëmundje - *disease, illness*
 sistematik - *systematic*
 shitës markéti - *grocer salesman*
 specialist - *specialist*
 shoqëror, social - *social*
 të ftohtë (noun) - *coldness*
 trajtim, terapí, kurím mjekësór -
illness (medical) treatment
 vesh (hearing organ) - *ear*

Attributive clauses · again

Kush - *who*, (for this see lesson 4), is used only for people. It becomes **i kujt, e kujt, të kujt** (*whose*) in genitive case and **kë, cilin, cilët; cilën, cilat** (*whom*), if used as an object (accusative case).

Që (*that*) is used in attributive clauses to name people. In common language this **që** is replaced by **kush** (*who*).

Që (*that*) is used after a comparison of the superlative degree (see lesson 49), or after an ordinal number. Examples:

Kush është ai, ajo, ata, ato që ... (*who is it that ?*).

Që is also used after **gjithë, të gjithë** (*all*), **ndonjë** (*any*), **vetëm** (*only*), **asgjë** (*nothing*), **asojë** (*none*), **secili, secila, secilët, secilat** (*anyone*). Examples:

Ti je i vetmi njeri që nuk e pëlqen këtë libër.
You are the only one that does not like this book.
Kush ishin të gjithë ata që takove tek stacioni i trenit?
Who were all of them that you met at the train station?

Që (*that*), **cilin, cilët, cilën, cilat** (*that, whom*), if they play the role of an object, may not be omitted as in English constructions. Examples:

Njeriun që pashë unë ...

The man (whom) I saw...

Njeriun të cilin unë e pashë ...

The man (whom) I saw...

Të cilin, të cilët, të cilën, të cilat (*whom*) are used with prepositions. Put the preposition in the right place in the sentence. In English, generally speaking, the prepositions are found at the end of the sentence. Examples:

Njeriun me të cilin unë po flisja... .

The man whom I was talking to...

Fotografia që ju po shihnit

The photo that you were looking at.



Conversation (Track 45)

Iliri: Ky është pavijoni i të sëmurëve ambulatorë.¹⁾

Helena: H'm! Të sëmurë ambulatorë! E ç'janë ata?

Iliri: Ata janë njerëz të sëmurë, por që nuk kanë nevojë të qëndrojnë në spital. Ja, ata njerëzit që ju shihni aty të ulur në ato ndënjese - ata janë të sëmurët ambulatorë.²⁾

Xhoni: Disa prej tyre duken si në shtëpinë e tyre këtu! ³⁾

Iliri: Oh po, ka disa që vijnë këtu rregullisht për kurim. Për kurimin e disa sëmundjeve kërkohet kohë e gjatë.⁴⁾

Helena: Cila ishte ajo zonjusha me të cilën po bisedonit? A ishte infermiere?

Iliri: Jo, ajo ishte një punonjëse shoqërore, një farë punonjëseje shoqërore, e cila ndihmon të sëmurët në çështjet e tyre shtëpiake.⁵⁾

Helena: Taní ajo është një grua, puna e së cilës duket interesante.

Xhoni: Po, e dashur - por nuk është ai lloj pune që mund të bësh ti! ⁶⁾

Helena: Jo, unë nuk jam mjaft sistematike. Meqë ra fjala, Dr. Bégu, kush ishte ai burri që takuam në korridor? Ai nuk ishte i sëmurë, apo jo?

Iliri: Jo, ai është një mjek i ri që njoh unë. Ai është specialist për sëmundjet e veshit, të hëndës dhe të grykës. Një djalosh shumë i aftë.⁷⁾ Ai mund të kurorë pothuajse gjithçka. Por mos shko tek ai nëse ke ndonjë të ftohtë!

Xhoni: Përsë jo? ⁸⁾

Iliri: Nuk e di? Ajo është e vëtmja gjë që ne mjekët nuk shërojmë - të ftohtët e zakonshëm!

Explanations: 1) Ky është pavijoni i të sëmurëve ambulatorë (të jashtëm) - *This is the out - patients' department* - 2) janë të sëmurë të jashtëm (të shërbimit ambulator) - *they are out - patients.* - 3) Disa prej tyre duken si në shtëpinë e tyre; Disa prej tyre e ndiejnë veten si në shtëpinë e tyre - *Some of the them look quite at home here!* - 4) Duhet një kohë e gjatë për të kuruar disa sëmundje; Kërkohet një kohë e gjatë për kurimin e disa sëmundjeve - *It takes a long time to cure some illnesses.* - 5) i ndihmon të sëmurët për problemet e tyre

shtëpiake (familjare) - *helps the patients with their domestic affairs.* - 6) ai lloj pune që ti mund të bësh - *the sort of job you can do.* - 7) një djalosh shumë i zoti (i shkathët, i aftë) - *A very clever (able) chap.* - 8) Përse jo?; - *Why not?*

Notes about the conversation: 1. The adjective **i, e, të sëmurë**, shows that someone is sick, or is suffering from a disease. If this adjective is used as a predicate and not as a qualitative adjective, translate it *ill*, as in this example: **Ai njeri është i sëmurë** (*That man is ill*).

The sentence **Ai është një njeri i sëmurë**, in English would be translated in this way: *He is a sick man.* A good translation requires the use of the adjective *sick*.

This one has the function of an attribute. But, **i sëmurë, e sëmurë, të sëmurë** in Albanian are also used as nouns, therefore, in this case, use *a patient*, or *patients*. Since **pacientë, klientë** are customers of a doctor, you may use *patients*, or *practice*, accordingly: Examples:

	Mjeku im ka shumë klientë.
or	Mjeku im ka shumë pacientë.
	<i>My doctor has many patients;</i>
or	Mjeku im ka një praktikë të madhe.
	<i>My doctor has a large practice.</i>

2. **Në shtëpi; Si në shtëpinë (tuaj)** - *at home.* Note the expression: **Rrini si në shtëpinë tuaj!** - *Make yourself at home!*

3. **Ndihmoj (ndihmoj në diçka, or ndihmoj për diçka)**, is used for the object with a preposition after the verb, and is translated *to help with*, as in these examples: **A mund t'ju ndihmoj për ...?** (*May I help you with ...?*); **Ndihmoje nënën për të pastruar shtëpinë** (*Help our mother with cleaning the house*).

4. **Meqë ra fjala; meqë e solli fjala; me qenë se e solli biseda**, etc., are translated *by the way*. Example: **Meqë ra fjala, na trego për udhëtimin tuaj në Itali** - *By the way, tell us about your trip to Italy.*

Reading exercises

1. **Postier, sjell letrat:** Postieri është njeriu që sjell letrat: Postier, sjell letrat: Postieri është njeriu që sjell letrat. - **Doktor, kuron të ftohtin tuaj:** Doktor është njeriu që kuron të ftohtin tuaj. - **Punonjësi shoqëror, ndihmoj të sëmurët:** Punonjësi shoqëror është njeriu që ndihmon të sëmurët. - **Shitës ushqimor, shet sheqer:** Shitësi ushqimor është njeriu që shet sheqer. - **Drejtori, drejton uzinën:** Drejtori është njeriu që drejton uzinën.

2. **A ia dhe librin djaloshit? Po, ai është djaloshi që ia dhashë librin:** A ia dhe librin djaloshit? Po, ai është djaloshi që i dhashë librin. - **A e vendosët librin mbi tavolinë?** Po, ajo është tavolina mbi të cilën e vendosa librin. - **A u ulët në atë karrige?** Po, ajo është karrigia që u ula unë. - **A deshët të shkoni në atë (tek ajo) dramë?** Po, ajo është drama në të cilën (tek e cila) unë desha të shkoja.

3. Ja tek është ai. Ne e pamë dje atë njeri. Po, ai është njeriu që e pamë dje: Ja tek është ai. Ne e pamë dje atë njeri. Po, ai është njeriu që e pamë dje.- Shihe atë. Ne e pamë atë veturë javën e shkuar. Po, ajo është vetura që pamë javën e shkuar.- Kush është ai? Ne folëm më parë me atë djalosh. Po, është ai djaloshi me të cilin folëm më parë. - Sa vajzë e gjatë! Ne e pamë atë të shtunën në vallëzim. - A nuk është mjeku ai?- Ne e takuam atë në spital muajin e shkuar. Po, ai është mjeku që e takuam në spital muajin e shkuar.

Practice exercises

1) Answer these questions: 1. *Në cilën pjesë të spitalit janë miqtë tanë?* - 2. *Ç'është një pacient i jashtëm?* - 3. *Përse mendoni se pacientët e jashtëm janë ulur në ndenjësë?* - 4. *Atëherë çfarë është një pacient i shtruar në spital?* - 5. *A është kjo hera e parë që ata kanë qenë në spital?* - 6. *A munden mjekët të kurojnë të gjitha sëmundjet?* - 7. *Ç'është një infermiere spitali?* - 8. *Si quhet një punonjës shoqëror spitali?* - 9. *A është Helena një njeri i përshtatshëm për të qenë një punonjës shoqëror?* - 10. *Ç'është një specialist?* - 11. *Çfarë bëni ju kur keni një të ftohtë?*

2) Define the nouns in this way: *Një dhomë gjumi është një dhomë në të cilën flemë* (A bedroom is a room we sleep in). *Një punonjës i asistencës është një njeri që ndihmon të sëmurët e spitalit* (A social worker is a person who helps patients). Use attributive clauses to explain the meaning of the words. Do the same to define the following nouns. Use the vocabulary at the end of this book: 1. *Makinë shkrimi.* - 2. *Karrige.* - 3. *Laps.* - 4. *Mjek.* - 5. *Shqiptar.* - 6. *Pardey.* - 7. *Drejtor banke.* - 8. *Gazetar.* - 9. *Kopsht zoologjik.* - 10. *Muzikant.*

3) Translate into Albanian: 1. Who is that young lad with whom you were walking along the streets of our town? - 2. I have never met someone who likes that book. - 3. He is the grocer we usually go to. - 4. This is the boy that we found in our garden. - 5. Tell me the name of someone you know in Tirana.

Lesson 45 / Mësimi dyzet e pesë
Forty-fifth Lesson / Mësimi i dyzetëpestë
Vocabulary / Fjalorth

apendicit - *appendicitis*
befasisht: papritmas - *suddenly*
bojaxhi - *painter*
bllok, cöpë - *block*
hallë, téze - *aunt*
i (të) përshtatshëm, i (të)
 - *volitshëm - convenient*
shtëpë, leckë - *mop*
lis - *oak-tree*
lyej me bojë, bojatis - *(to) paint*
shndrit, shkëlqej - *(to) polish, (to) shine*
kujdësem, tregoj kujdës për (diçka, dikë)
 - *(to) look after*

kusht, gjëndje - *condition*
ndonësë, megjithësë - *though*
parkët - *parquet*
punime druri - *woodworks*
 - **punë me dru** - *woodwork*
punë shtëpie (shtëpiake) - *housework*
rrezik - *danger*
shtojcë - *appendix*
turpërohem - *(to) be ashamed;*
 - **bëhem me turp;**
i (të) turpshëm - *(to) be shy*

Transitive verbs and passive voice

The passive voice of the verbs is made by means of the auxiliary verb **jam** (*to be*) followed by other parts of the speech, accordingly.

The verbs of the passive voice are followed by two prepositions: **nga** (this requires the nominative case) or **prej** (this requires the ablative case). These ones are translated *by*. Examples:

Active

Sokoli thëu xhamin e dritares.
Sokol broke the window.
Sokoli përziën supën.
Sokol is stirring the soup.
Librarët porositën libra.
The librarians ordered books.
Mësuesi vlerësoi provimet.
The teacher graded the tests.
Ne do të sjellim kutitë.
We will bring the boxes.
Ne do të sjellim librat.
We will bring the books.
Unë nuk do ta bëj atë punë.
I will not do that work.
Unë nuk do ta bëj atë punë.
I will not do that work.

Passive

Xhami i dritares u thyë nga Sokoli.
The window was broken by Sokol.
Supa po përzihet prej Sokoli.
The soup is being stirred by Sokol.
Librat u porositën prej librarëve.
Books were ordered by librarians.
Provimet u vlerësuan nga mësuesi.
The tests were graded by the teacher.
Kutitë do të sillen nga ne.
The boxes will be brought by us.
Librat do të sillen prej nesh.
The books will be brought by us.
Ajo punë nuk do të bëhet nga unë.
That work will not be done by me.
Ajo punë nuk do të bëhet prej méje.
That work will not be done by me.

Notes: Do not confuse an intransitive verb with a verb in passive voice. It's only the passive voice that requires the verb **jam** (*to be*), while the intransitive verbs in compound tenses require the verb **kam** (*to have*). Examples:

Unë pata ikur (active, intransitive). *I had gone.*
Ajo ishte thyer (passive, transitive). *It was broken.*

Active voice

Dikush	zien	ujin.
Somebody	boils	the water.
Dikush	është duke larë	veturën.
Somebody	is washing	the car.
Dikush	ka marrë	paratë e mia.
Somebody	has taken	my money.
Dikush	ka qenë duke djegur	letra.
Somebody	has been burning	papers.
Dikush	do ta bëjë	atë.
Somebody	will do	it.
Dikush	do ta shkruajë	letrën.
Somebody	is going to write	the letter.
Dikush	hapi	portën
Somebody	opened	the door.
Dikush	ishte duke bërë	pyetje.
Somebody	was asking	questions.
Dikush	kishte parkuar	veturën.
Somebody	had parked	the car.
Dikush	mund ta heqë	këtë gotë.
Somebody	can move	this cup.
Dikush	duhet ta mësojë	atë djalë.
Somebody	ought to teach	that boy.
Dikush	duhet të fshijë	dhomën.
Somebody	must clean	the room.

Passive voice

Uji	është	zier.
The water	is	boiled.
Vetura	është	duke u larë.
The car	is	being washed.
Ajo	do të	bëhet së shpejti.
It	will	be done soon.

Lesson 45 / Mësimi dyzet e pesë

Letra	do të	shkruhet.
<i>The letter</i>	<i>is going to</i>	<i>be written.</i>
Dera	u	hap.
<i>The door</i>	<i>was</i>	<i>opened.</i>
Pyetjet	ishin	duke u bërë.
<i>Questions</i>	<i>were being</i>	<i>asked.</i>
Një veturë	kishte qenë	parkuar.
<i>A car</i>	<i>had been</i>	<i>parked.</i>
Ai	duhet	të mësohet.
<i>He</i>	<i>ought to</i>	<i>be taught.</i>
Dhoma	duhet	të pastrohet.
<i>The room</i>	<i>must</i>	<i>be cleaned.</i>

To turn a sentence from active voice to a passive one you should inverse the subject and the object. The subject should take the place of the object, and the object take the place of the subject. Examples:

Babai im (subject)	shkroi	një letër (object).
<i>My Father</i>	<i>wrote</i>	<i>a letter.</i>
Një letër (subject)	u shkrua	nga babai im (object)
<i>A letter</i>	<i>was written</i>	<i>by my Father.</i>

Examples: **Babai im i dërgoi një letër mjekut të tij.**
My father sent a letter to the doctor.
Një letër iu dërgua mjekut nga babai im.
A letter was sent to the doctor by my father.
Një letër iu dërgua mjekut prej babait tim.
A letter was sent to the doctor by my father.

There is another way to form the passive voice. If an indirect object is present in a sentence, then the indirect object takes the place of the subject. Examples:

Nëna ime dërgoi një një letër tek unë (the subject, active voice)
My mother sent a letter to me.
Mua (the subject) m'u dërgua një letër nga nëna ime. (passive voice)
I was sent a letter by my mother.

This construction is used in these cases: a) if the indirect object is not clearly expressed, b) if the sentence has an impersonal or unspecified form.

Më thanë se ti kishe mbërritur.	<i>I was told you had arrived.</i>
Më pyetën për adresën tuaj.	<i>I was asked for your address.</i>

Active voice

Një grúa po kujdeset për fëmijën tonë.

A woman is looking after our baby.

Passive voice

Për fëmijën tonë është duke u kujdesur një grúa.

Our baby is being looked after.

Other possible translations regarding the passive voice: **Ata dërguan fjalë për mua**, will be translated as follows: *I was sent for* or *They sent for me*, and **Ata më shkruan një letër** - *I was written a letter to*.

I shqetësuar (worried), **i habitur** (surprised), **i interesuar** (interested), are participles which are used as adjectives. Therefore, do not get confused with their usages. Examples:

Jam i shqetësuar.

I am worried.

Ti dukesh i habitur.

You seem surprised.

Ai është i interesuar për biznesin tonë. *He is interested in our business.*



Conversation (Track 46)

Elsa: Znj. Bégu, kjo është një shtëpi shumë e rehatshme, apó jo?

Doroti: Po, ajo është tépër e volitshme. Dhe ajo nuk është në kushte të këqija, megjithatë. Ajo është ndërtuar më 1910. Por më vjen turp për pjesën e jashtme.¹⁾ Punimet prej druri duhet të bojatësen së shpejti.²⁾

Elsa: Sa dyshemë e mrekullueshme që është kjo!

Doroti: Ai qëhet parkët; është bërë prej cópash lísi. Por duhet të lustrohet çdo javë.

Elsa: Znj. Bégu, a mund t'ju ndihmój në punët túaja të shtëpisë?

Doroti: Oh, e dashur, nëse të pëlqén.³⁾ Shtúpën e mbajmë në dollápin poshtë shkallëve ... ! Oh Zot, ky dolláp nuk është pastruar për një kohë të gjatë.⁴⁾ Ja shtëpa, Elsa.

Elsa: Falemindërit.

Doroti: Znj. Benedíkt! Znj. Benedíkt!

Elsa: Si është púna, Znj. Bégu?

Doroti: Sapó më telefonúan dhe më duhet të largóhem menjëherë.⁵⁾ Mótra íme është e sëmúrë.⁶⁾

Helena: Oh, më vjen keq, Znj. Bégu.

Elsa: Është téze Zana?! Si është púna me të?

Doroti: Apendicít. Më thanë në telefon një minútë më parë.⁷⁾ Është një rast i keq.⁸⁾ Apendicíti i është hequr. Mjékët mendójnë se ajo është jashtë rrezikut tashmë. Por i është lënë tépër gjatë; dhe ajo është shumë e sëmúrë me të vërtetë.

Lesson 45 / Mësimi dyzet e pesë

Helena: Oh, atëherë ti duhet të shkosh tek ajo menjëherë.

Doroti: Po, po, mendoj se do të bëja mirë. Jam e sigurt se ata kanë bërë gjithçka që mund të bëhet; por unë do të doja ta shihja. Do të kthëhem përsëri këtë mbrëmje.

Explanations: 1) Më vjen turp për pjesën (anën) e jashtme (të shtëpisë). - *I'm ashamed of the outside.* - 2) duhet të bojatisen së shpejti - *must be painted soon.* - 3) nëse të pëlqen; po të kesh dëshirë; nëse dëshiron - *if you like.* - 4) nuk është pastruar (bojatisur, lyer me bojë) për një kohë të gjatë - *it hasn't been cleaned (painted) for a long time.* - 5) Sapo më telefonuan dhe më duhet të largohem menjëherë (befas, papandehur) - *I've been called away suddenly and I have to leave right away.* - 6) u sëmur - *has been taken ill.* - 7) Ma thanë në telefon një minutë më parë - *I was told on the telephone a minute ago.* - 8) Është një rast i keq - *It is a bad case.*

Reading exercises

1. Njerëzit e përdorin këtë libër në të gjitha vendet. Ky libër përdoret në të gjitha vendet: Njerëzit e përdorin këtë libër në të gjitha vendet. Ky libër përdoret në të gjitha vendet. - Ata e bëjnë stërvitjen në Shqipëri. Stërvitja bëhet në Shqipëri. - Dikush pastron veturat këtu. Veturat pastrohen këtu. - Ne vendosim të gjitha pjesët së bashku. Të gjitha pjesët vendosen këtu. - Ata bëjnë dysheme prej copash lisi. Dyshemeja bëhet prej copash lisi.

2. Ne do t'i bëjmë perdet prej pambuku. Perdet do të bëhen prej pambuku: Ne do t'i bëjmë perdet prej pambuku. Perdet do të bëhen prej pambuku. - Ata po bënin një vrimë në mur. Një vrimë ishte duke u bërë në mur. - Njerëzit mund ta shohin prej këtej. Ajo mund të shihet prej këtej. - Dikush mund ta pastrojë këtë dhomë. Kjo dhomë duhet të pastrohet. - Dikush ka marrë paratë e mia. Paratë e mia janë marrë.

3. Ai duket, i çuditur. Ai u duk i habitur: Ai duket, i çuditur. Ai u duk i habitur. - Ti, m'kesh i mërzitur: Ti u duke i mërzitur. - Ajo, mban erë: Ajo mbante erë të djegur. - Unë, ndiej, m'ban: Unë u ndjeva i humbur. - Ata, qëndrojnë, palëvizur. Ata qëndruan të palëvizur.

Practice exercises

1) Change to passive voice, and if necessary, leave out the subject of the active sentence: 1. Ne mbajmë gjalpë në këtë bufë. - 2. Ata po ndërtojnë një shtëpi të re në anën tjetër të rrugës. - 3. Dikush ka pirë të gjithë birrën time. - 4. Orkestra do të luajë tani "Himnin Kombëtar". - 5. Ne do të shpikojmë këto valixhe. - 6. Ata zgjodhën një vajzë tjetër për punën e sekretares. - 7. Disa njerëz po vendosnin rafte në banjë. - 8. Dikush më pati shpjeguar situatën. - 9. Ti mund ta pastrosh këtë shumë shpejt. - 10. Dikush duhet të sjellë një mjek.

2) Write the following sentences in passive voice. Use these phrases: *disa njerëz* (some people), *disa punëtorë* (some workers), *disa boja:hinj* (some painters), or *ne* (we). Example: *Dikush do të bojatisë punimin prej druri së shpejti* (somebody must paint the woodwork soon).

Lesson 45 / Mësimi dyzet e pesë

The following are verbs in passive voice: 1. *Duhet të pastrohet.* - 2. *Ka nevojë të lustruhet.* - 3. *Mirëmbahet.* - 4. *Nuk ka qenë pastruar.* - 5. *U kërkua të largohet.* - 6. *U tha.* - 7. *U nxorën.* - 8. *Kishte mbetur.* - 9. *Mund të bëhet.*

3) Answer to the following questions applying this example: *Një dyshe me parketi bëhet prej copash lisi* (A parquet floor is made of oak - blocks): 1. *Nga se bëhet një tavolinë?* - 2. *Nga se bëhet një libër?* - 3. *Nga se bëhet një dritare?* - 4. *Nga se është bërë këmbisha juaj?* - 5. *Nga se bëhet një cigare?*

Lesson 46 / Mësimi dyzet e gjashtë
Forty-sixth Lesson / Mësimi i dyzetegjashtë
Vocabulary / Fjalorth

ajo vetë (inanimate nouns) - *herself*
ai vetë - *himself*
ai, ajo vetë - *itself*
arnoj - (to) *mend*
ata vetë, veten e tyre - *themselves*
bëhem më keq - (to) *get worse*
daktilograf - (to) *type*
dëmtoj - (to) *damage*
ekspert, specialist - *expert*
i (e, të) vrazhdë, brutal - *rude, tough*
i zi (të) zinj; e zëzë, (të) zëza - *black*
ju vetë, veten - *yourselves*
frëna - *brakes*
kontrolloj - (to) *overhaul*

mendoj, marr me mend - (to) *suppose*
më keq, më i keq - *worse*
ne vetë - *ourselves*
i (e, të) pafytyrë - *cheek, cheeky*
paguaj (për) - (to) *pay (for)*
përvëç - *besides*
pres - (to) *cut*
radiator - *radiator*
rregulloj, regjistroj - (to) *adjust*
rrjedh, pikon - (to) *leak*
shëmbull - *example*
thyej, copëtoj - (to) *break*
unë vetë, vëtja ime - *myself*
vaj (ulliri) - (olive) *oil*

The reflexive pronouns unë vetë, vetë unë (I myself), etc.

Unë vetë, vetë unë (I myself); **ti vetë, vetë ti** (you yourself); **ai vetë, vetë ai** (he himself); **ajo vetë, vetë ajo** (she herself); **ai vetë, ajo vetë** (itself), **ne vetë, vetë ne** (we ourselves); **ju vetë, vetë ju** (you yourselves); **ata vetë, vetë ata; ato vetë, vetë ato** (they themselves), if used close to a noun or a pronoun, are called **emphatic pronouns**. **Vetë** is used without any prepositions. Examples:

Unë e pashë vetë.
Ato e panë vetë.
Ne e pastruam vetë kopshtin.
Nxënësit e lyen vetë shkollën.

I saw it myself.
They saw it themselves.
We cleaned the garden ourselves.
The students themselves painted the school.

Table no. 70 (Reflexive pronouns)

Person	Singular		Plural	
1st person	unë vetë	I myself	ne vetë	we ourselves
2nd person	ti vetë	you yourself	ju vetë	you yourselves
3rd person	ai vetë	he himself	ata vetë	they themselves
	ajo vetë	she herself	ato vetë	they themselves
	al, ajo vetë	it itself	ata, ato vetë	they themselves

Lesson 46 / Mësimi dyzet e gjashtë

These pronouns help to translate the pronominal phrases, such as: **nga vetë unë, nga unë vetë** (*by myself*), **nga vetë ti, nga ti vetë** (*by yourself*), etc. See the following examples:

E bëra unë vetë.	<i>I did it myself.</i>
E bëra vetë unë.	<i>I did it myself.</i>
E bëmë ne vetë.	<i>We did it ourselves.</i>
E pashë unë vetë.	<i>I saw it myself.</i>
Unë vetë e pashë.	<i>I myself saw it.</i>

(It's preferable to place the reflexive pronoun at the end of the sentence).

Unë do ta bëj atë vetë.

I shall do it myself.

Unë nuk dua t'i shkruaj atij, përse nuk i shkruan ti vetë?

I don't want to write to him, why don't you write yourself?

The possessive adjective vet (i vet, e vet, të vet) - his/her own - again

I vet, e vet, të vet correspond with the English possessive pronouns *his own, her own, or their own*, as in the following examples: **biri i vet** (*his own son*), **bashkëshorti i vet** (*her own husband*), etc. The table below shows the inflection of (**i, e**) **vet** after a noun. See also lessons 5. and 8.

Table no. 71 (Possessive adjective **i vet, e vet** - his/her own)

	Property is singular		Property is plural	
	Masculine	Feminine	Masculine	Feminine
Nom.	i vet	e vet	e vet	e veta
Gen.	i, e, të vet	i, e, së vet	i, e, të vet	i, e, të veta
Dat.	të vet	së vet	të vet	të veta
Acc.	e vet	e vet	e vet	e veta
Abl.	të vet	së vet	të vet	të veta

If **i vet** is used separate from the noun, that is as a possessive pronoun, it will appear in this way:

	Singular	Plural
Masculine:	i veti	të vetët
Feminine:	e veta	të vetat

The emphatic forms of me vete (with me)

This is used with a preposition, but it may be used as a noun, as in the following sentence:

Do ta marr me vete librin.

I will take the book with me.

Lesson 46 / Mësimi dyzet e gjashtë

Ai punon për vete.	<i>He works for himself.</i>
Ai punon për veten e tij.	<i>He works for his won.</i>
Unë e kam librin me vete.	<i>I have my book with me.</i>
Ai flet me veten e tij.	<i>He speaks to himself.</i>

Usages of the verbs duhet (to have) and jam (to be)

Duhet (*have to, must, should, ought to*) is used to indicate necessity need, or constraint.

Examples:

Ai është duke pritur jashtë, ty do të duhet ta takosh.
He is waiting outside, you'll have to see him.
Më duhej ta shihja (or ta takoja atë).
I had to see him.

Use the verb *to do* to translate the Albanian modal verb **duhet** in interrogative sentences.

Examples:

A t'u desh ty të hapje dërrën?	<i>Did you have to open the door?</i>
Sa herë të duhet të shkosh në zyrë?	<i>How often do you have to go to the office?</i>

Duhet, is also used to express the accomplishment of a regular duty. In this case it may be translated with *must* or *to have to*, as in the following examples:

Më duhet të shkoj në zyrë (tani).	<i>I must go to the office (now).</i>
Jam i detyruar të shkoj në zyrë.	<i>I have to go to the office.</i>

To show lack of need, rather than prohibition, or constraint, use the negative of this verb, as in the following phrases: **nuk duhet, nuk është nevoja, s'ka nevojë** (*not to have to*).

Example:

Nëse ti nuk ndihesh mirë, nuk është nevoja të shkosh.
You don't have to go if you don't feel well.



Conversation (Track 47)

Iliri:	Petrít, ajó déra e garazhit që ti théve - nuk është ndréqur ende.
Petríti:	Jo, nuk mendoj se mund të ndréqet. Është e gjitha e thyer. Do të na duhet të blëjmë një dërrë të re.
Iliri:	Ajo do të kushtojë shumë para.
Petríti:	Mendoj se do të më duhet të pagúaj për të. ¹⁾
Iliri:	Epó, në fund të fúndit, ti e théve. ²⁾
Petríti:	Por vetúra nuk u dëmtúa shumë, apó jo?
Iliri:	Jo, por ajó nuk është në kúshte të mira. Duhet t'i bëhet një kontróll i përgjithshëm.

- Petriti:** Bëra që të ndërróhej vaji javën e kaluar.
Iliri: Po, por, ka édhe shumë gjëra të tjera për t'u bërë, përvéc asaj. Për shémbull, radiatori rrjedh.³⁾ Ai do të bëhet édhe më keq nëse nuk riparóhet. Dhe frénat nuk janë duke funksionuar shumë mirë. Ató dúhet të regjistróhen.
Petriti: A e di Babá, nuk dua të jem i áshpër me ty,⁴⁾ por nuk mendoj se ti kujdésesh shumë për veturën tënde.
Iliri: Çfarë! Unë nuk kujdësem për të!
Petriti: Jo, një veturë dúhet të kontrollóhet rregullisht çdo tre muaj. PËyet Z. Benedíkt - ai është eksperti për veturat. Ti nuk e ke çuar për ta bërë këtë për afërsisht një vit. Sigurisht që shkon keq!
Iliri: Mirë, mirë, çfarë paturpësie!⁵⁾ Më lejo të të them, djalósh, flókët i ke shumë të gjata. Shko dhe qéthi!

Explanations: 1) Mendoj se do të më duhet të paguaj për të - *I suppose I shall have to pay for it* - 2) në fund të fundit, ti e theve - *after all, you broke it.* - 3) radiatori rrjedh (pikon) - *the radiator leaks.* - 4) A e di Baba, nuk dua të jem i áshpër me ty (brutal, i pasjellshëm) - *You know, Father, I don't want to be rude to you* - 5) Çfarë paturpësie! Sa i pafytyrë!, Sa i paturpshëm! - *Well, what a cheek!*

Notes about the conversation: See the place of *shumë* (very much) in a sentence:

Vetúra nuk ishte dëmtuar shumë.	<i>The car wasn't damaged very much.</i>
Múa nuk më pëlqén shumë uíski.	<i>I don't like whisky very much.</i>

Generally speaking, the adjectives are put after the nouns they modify, while the adverbs follow the object.

Note the verb **marr me mend** (*to suppose, to guess*). The meaning of this verb is the same with that of the verb **mendoj** (*to think*), or **shpresoj** (*to expect*). Example:

Epo, nëse ti nuk pranon ta bësh punën, mendoj se do të më duhet ta bëj unë.
Well, I suppose I'll have to do the job if you refuse to.

Note the use of the passive voice of the infinitive of the verb **bëj** (*to do*):

Ka shumë gjëra të tjera për t'u bërë.
There are a lot of other things to be done.

Reading exercises

1. **A ia rregulluan orën atij? Jo, ai e riparoj vetë:** A ia rregulluan orën atij? Jo, ai e riparoj vetë. - **A ia sollën asaj pakon? Jo, ajo e solli vetë.** - **A ua gatuan atyre ushqimin? Jo, ata e**

gatuan vetë. - A ia hapën portën atij? Jo, ai e hapi vetë. - A ia ndërruan asaj gomën? Jo, ajo e ndërroi vetë.

2. Xhakëtë: Mua do të më bëhet një xhakëtë javën që vjen. Oh, unë e bëj gjithnjë vetë timen. **Xhakëtë:** Mua do të më bëhet një xhakëtë javën që vjen. - Oh, unë e bëj gjithnjë vetë timen. - Ora ime, riparoi: Mua do të më riparohet ora javën që vjen. - Oh, unë e riparoi gjithnjë vetë timen. - Shtëpi, bojatis: Mua do të më bojatiset shtëpia javën që vjen. - Oh, unë e bojatis gjithnjë vetë timen. - Disa rafte, vendos: Mua do të më vendosen disa rafte javën që vjen. - Oh, unë i vendos gjithnjë vetë të miat. - Veturë, kontrolloj: Mua do të më kontrollohet vetura javën që vjen. - Oh, unë e kontrolloj gjithnjë vetë timen. - Pastroj dhomat: Asaj i janë pastruar dhomat. - Oh, unë i pastroj gjithnjë vetë të miat.

Sentences and phrases for lessons 45 and 46

Shko dhe sill atë burrin për të cilin po flisje, burrin, që të ndihmoi javën e kaluar.

Go and fetch the man you were talking about, the man, who helped you last week.

Kjo muzikë tingëllon më mirë kur luhet në një piano të mirë.

This music sounds better when it's played on a good piano.

Libri u shkrua nga ajo grua që ne pamë në kafënë mbrëmë.

The book was written by that woman we saw at the café last night.

A të kujtohet ajo dritare që u thye para një jave?

Do you remember that window that was broken a week ago?

Atyre u ndërtuan një garazh të ri, kur garazhi i tyre i vjetër ra.

They had a new garage built when their old one fell down.

A është bërë ndonjë gjë për të?

Has anything been done about it?

Na duhet të na e rregullojnë atë.

We ought to have it mended.

Practice exercises

1) Translate into Albanian: 1. He must go home by now. - 2. He always must get up at five o'clock in the morning. - 3. It was dark and I had to use a flash-light. - 4. He told me I had to leave the apartment. - 5. I suppose we had to invite them to dinner. - 6. How many times should you write to him? - 7. There was no need for them to come, if they didn't want to. - 8. He is not forced to work, because he has plenty of money. - 9. They will arrive tomorrow and I look forward to meeting them.

2) Change the following sentences in negative: 1. Ai i kishte vënë fotografitë e tij mbi piano. - 2. Atij iu vunë fotografitë e tij mbi piano. - 3. Më duhej të punoja dje gjithë ditën. - 4. Ai shkoi që të qethet. - 5. Atij i duhet shpesh të shkojë jashtë shtetit. - 6. Unë kam riparuar veturën. - 7. Mua m'u riparua vetura në garazh në Tiranë. - 8. Ajo është e shkëlqyer. - 9. Mua do të më duhet t'i përgjigjem asaj letrë. - 10. Asaj i duhet të pastrojë dhomat. - 11. Asaj iu pastruan dhomat. - 12. Ajo ka pastruar dhomat. - 13. Asaj i duhej t'i pastroheshin dhomat.

Lesson 47 / Mësimi dyzet e shtatë

Forty-seventh Lesson / Mësimi i dyzeteshtatë

Vocabulary / Fjalorth

bëja, i mësuar për të bërë - *used to*
bujqësi - *farming*
dritë dielli - *daylight*
drithë, grurë - *corn, harvest*
prodhim, të kórra (from fields) - *yield*
hujk, fermër - *farmer*
fushë - *field*
gjashhtë pënsë - *sixpence*
jashtë - *outdoor*
lopë - *cow*

përjashta - *outdoors*
keqardhje - *pity*
krenar - *proud*
kundërshtoj - *(to) object*
lëro, plugoj - *(to) plough*
më i larti - *the highest*
mjel - *(to) milk*
rezultat - *result*
heq viza, vizatôj - *(to) draw*
vjel (drithë, fruta) - *(to) reap*

The subjunctive mood

Let's see these sentences: Examples:

Më pëlqen të lexoj (subjunctive). *I like to read.*

Është kënaqësi që të takoj.

It was nice meeting you.

Pres me padurim që të takoj mikun tuaj.

I look forward to meeting your friend.

Which form to choose?

There are verbs which have to be followed either by a verb in the subjunctive mood, or by a neuter nouns. These verbs are: pëlqej (*like*) filloj, (*begin*), nis (*start*). Examples:

Ai filloi të shkruajë. (Subjunctive)

He began to write.

Ai filloi të shkruarit.

He began writing.

Mua më pëlqën të shkruaj. (Subjunctive)

I like to write.

Mua më pëlqën të shkruarit.

I like writing.

Some more examples:

Ai nisi të këndojë sapo mbërriti në shtëpi.

He started to sing as soon as he arrived home.

Ai nisi të kënduarit sapo mbërriti në shtëpi.

He started singing as soon as he arrived home.

Verbs that require subjunctive mood: pyes (*ask*), kundërshtoj (*refuse*), premtoj (*promise*), drejtoj (*manage*), vendos (*decide*), kam ndër mend (*intend*), shpresoj (*hope*).
Example: Shpresoj që puna të shkojë mirë (*I hope the work be a success*).

In some cases, using a certain verb or a certain noun, we change the meaning of the sentence, as in the following sentences:

Ky djalë dëshiron të lajë.
Ky djalë dëshiron një të larë.
Kujtôhu të postosh këtë lëter.
Më kujtôhet se e postova lëtrën.

This boy wants to wash.
This boy needs to be washed.
Remember to post this letter.
I remember posting it.

Shtëpi karakteristike, Shqipëria e veriut.
A characteristic house, northern Albania.



Conversation (Track 48)

- Xhoni:** A do të keni pushime këtë vit ¹⁾ Znj. Bégu?
- Doroti:** Po, jemi duke menduar të vizitojmë vëllain e Ilirit, Ladin, i cili është fermër.
- Xhoni:** Bujqësia është një punë shumë e këndshme, nëse nuk ke kundërshtim për të punuar fort.
- Iliri:** Po, dhe nëse nuk keni kundërshtim të ngriheni në pesë të mëngjesit. ²⁾
- Doroti:** Epô, Ilir, si mjek, ti je mësuar të ngrihesh natën!
- Iliri:** Po, vërtet, ³⁾ dhe këtu kam një lëter nga Ladi. E dashur, hape dritën, a do ta hapësh? Drita e diellit nuk është e mirë për të lexuar.
- Doroti:** A do të kishe kundërshtim të tërhiqje përdet, Z. Benedikt?
- Xhoni:** Oh po, sigurisht.
- Doroti:** Aty! Në rrëgull. Nuk më pëlqën të rri ulur në errësirë.
- Iliri:** Ladi thotë këtu, se gruri i tij është gati për korrje. Dhe ai po mendon që vitin tjetër të blëjë më shumë fusha.
- Xhoni:** Oh, ai duhet t'i këtë punët mirë. ⁴⁾
- Iliri:** Po, mendoj se i ka mirë.
- Doroti:** Ai është shumë krenar që ka patur prodhimin më të lartë të qumështit në krahinën e tij.
- Xhoni:** Shpresoj se ju po prisni me padurim që ta shihni atë.
- Iliri:** Po, sigurisht që jemi. Dhe unë do të bëj disa ushtrime fizike. A e dini se kur isha i ri, isha shumë i mirë për plugim. ⁵⁾ A keni provuar ndonjëherë të plugoni, Z. Benedikt?

Xhoni: Jo, por një herë provova dorën për të mjelë një lopë.⁶⁾ Rezultati ishte i tmerrshëm! Nuk do të harroj kurrë pamjen keqardhëse në fytyrën e asaj lope!

Explanations: 1) A do të keni pushime?, A do të bëni pushime? - *Are you going to have a holiday?* - 2) të ngriheni në pesë të mëngjesit - *to get up at five o'clock in the morning.* - 3) Po, vërtet - *Well, as a matter of fact, Yes, really.* - 4) Ai duhet t'i ketë punët mirë; atij i shkojnë punët mbarë - *he must be doing well.* - 5) Unë kam qenë mjaft i mirë për të pluguar (në plugim, në të lëruar) - *I was quite good at ploughing.* - 6) një herë provova të milja një lopë - *I once tried my hand at milking a cow.*

See some examples using adverbs, adjectives, or gerunds after the verb:

Ti nuk je kúndër që të punohet fort.

You don't object to working hard.

Ti je mësuar shumë që të ngrihesh hërët.

You are quite used to getting up early.

Dríthi është gáti për t'u kórrur.

The corn is ready for reaping.

Drita është e mjaftueshme për lexím.

The light is good enough for reading.

Aí është krenar që është një bujk i mirë.

He is proud of being a good farmer.

Aí provói të shkruante një libër.

He tried his hand at writing a book.

Përpíqem means: **vë forcat, mundohem të bëj një veprim (try to do).** **Provój** (try doing). Examples:

Përpíqu ta mbarësh punën përpára orës pësë.

Try to finish your work before five o'clock.

Provo supën që kam gatúar për ty.

Try the soup I have cooked for you.

Reading exercises

1. **Pirja e duhanit, të bën keq: Të pirit e duhanit të bën keq:** Pirja e duhanit, të bën keq: Të pirit e duhanit të bën keq. - Ndihmë, njerëz, mirësjellje: Të ndihmosh njerëzit është mirësjellje.- Jetoj, jashtë shtetit, ndryshe: Të jetuarit jashtë shtetit është ndryshe. - Nxë shqip interesante: Të nxësh (learning) shqip është interesante. - Shëtit, mirë për ty: Të shëtiturit të bën mirë.- Shkruaj, letra, e vështirë: Të shkruarit e letrave është e vështirë.

2. **Largohem: Çfarë po mendoni të bëni? Po mendoj të largohem:** Largohem: Çfarë po mendoni të bëni? Po mendoj të largohem. - Punoj: Çfarë kundërshtoni të bëni? Kundërshtoj:

Lesson 47 / Mësimi dyzet e shtatë

të punoj.- Vrapoj: Për çfarë je i mirë? Jam i mirë në të vrapuar.- Jap mësim: Për çka je krenar? Jam krenar të jap mësim. - Drejtoj veturën: Për çka je mësuar të bësh? Jam mësuar të drejtoj veturën.

3. Provoj, flas shqip: A keni provuar të flisni shqip?: Provoj, flas shqip: A keni provuar të flisni shqip? - Mendoj për, pi duhan me llullë: A keni menduar për të pirë duhan me llullë? - Jap mësim, lexoj dhe shkruaj: A keni dhënë mësim për lexim dhe shkrim? - Flas për, vizitoj Shqipërinë: A keni folur për të vizituar Shqipërinë? - Filloj, lyej shtëpinë: A keni filluar të lyerit e shtëpisë?

Practice exercises

1) Translate into English: 1. Ju falenderoj që më shkruat. - 2. Është kënaqësi të dëgjosh muzikë të mirë në radio. - 3. Shiu pushoi dhe dielli po shkëlqen. - 4. Krehja e flokëve ndihmon që të forcohen. - 5. Shpresoj se do të më falësh që bëra gjithë ato pyetje (*that I asked you a lot of questions*). - 6. Nuk ka përse të të vijë turp që të bësh pyetje. - 7. Ka qenë gjithnjë kënaqësi për të punuar në këtë zyrë. - 8. Ai premtoi ta provonte edhe një herë. - 9. Ne nuk e dëgjuam atë program javën e shkuar. - 10. Ai thotë se e kujton me kënaqësi kohën që kaloi me ne. - 11. Unë mendoj se pritëm gjysmë ore. - 12. Unë nuk mund të mos e mendoj se ata do të arrijnë shpejt. - 13. Policia nuk pranoi t'i kthente atij pasaportën. - 14. Kjo veturë ka nevojë për riparim. - 15. Unë më përpiqem të mbaj në rregull dhomën, por ai vazhdon të lërë sende mbi piano. - 16. A u kujtove të fikësh dritat? - 17. Po, më kujtohet që i fika para se të largohesha nga zyra. - 18. Eja të më shikosh pasi të kesh mbaruar së shkruari me makinë shkrimi ato letra. - 19. Unë u lodha së dëgjuari të lloj muzike. - 20. Dëgjimi i një mësimi të gjatë të shqipes mbasditë, më lodh.

2) Answer these questions: 1. Ku do të shkojë familja Begu për pushime? - 2. Cila është ana e Ladit, vëllait të Ilirit? - 3. A mundet që një njeri të kënaqet me punën e fermës? - 4. Përse duhet mjekëve që ndonjëherë të ngrihen natën? - 5. Përse do Iliri që Dorotia të hapë dritën? - 6. Kujt i lutet ajo që të tërheqë perdet? - 7. Ç'ka ndërmend Ladi të bëjë drithin e tij? - 8. Përse mendon Xhoni se Ladi është duke e kaluar mirë? - 9. A do të ishte mirë për Ilirin të vizituarit e fermës?

3) Use the following sentences and try to write a letter to your friend in America: Verën e kaluar, unë vajta për të kaluar pushimet në fshat ku xhaxhai im ka një fermë. Jeta në fshat është e bukur nëse je i mësuar të ngrihesh në orën pesë të mëngjesit dhe të punosh shumë (very hard).

Mua më pëlqen të shkoj në fushë me bujkun për të parë grurin e pjekur dhe për ta korrur. Kam provuar edhe të lëroj. Xhaxhai thoshte se plugoja mirë. Një herë unë provova edhe të mjel llopë. Duhej ta kishe parë vështirimin keqardhës të asaj lope të shkretë.

Lesson 48 / Mësimi dyzet e tetë
Forty-eighth Lesson / Mësimi i dyzetetetë
Vocabulary / Fjalorth

bëj provë (vesh-mbathje) - (to) fit on
bifték - steak
budalla - silly
dyqan kasapi - butcher's shop
i bie ziles - (to) ring
i (e, të) njëjtë - same
lajm, njoftim, mesazh, - news, message
mjaltë - honey
kasap - butcher
pjek, thek në skarë - (to) grill

pöçe, qyp, kavanoz - pot
porosit, urdhëroj - (to) order
provë - fitting
qëllim, synim - purpose
qytët - town, city
rrobaqépës - tailor
telefon - phone (telephone)
telefonoj - (to) call, (to) ring up
tjetër - else
ziej - (to) stew

The indefinite pronoun - tjetër, tjetri (other, the other, else, next) -
Tjetër (other) and **tjetri** (the other) are indefinite pronouns. **Tjetër** means another thing of the same kind, but not that particular one. Examples:

Unë do të vij ndonjë ditë tjetër.
Këtu është vetëm një libër.
Ku është tjetri?

I shall come some other day.
Here is only one book.
Where is the other?

Tjetër may also be used separately. Do not confuse the indefinite pronoun **tjetër** (other) **tjetri** (the other) with **tjetër** (else).

Tjetër (else) is associated by a group of words that have other indefinite pronouns, such as: **diçka** (something), **asnjë, asnjëri, as një njeri** (none, nobody), **kudo** (everywhere), et. Examples:

Asgjë tjetër.
Dikush tjetër.
Ai nuk dinte asgjë tjetër.
Kush tjetër e di këtë ngjarje?

Nothing else.
Someone (or somebody) else.
He didn't know anything else.
Who else knows this story?

A doni diçka tjetër?
 This means: **ndonjë gjë, diçka tjetër.**
Jo, unë nuk dua gjë tjetër.
 This means: **asgjë tjetër,**

Do you want anything else?
No, I do not want anything else;

Një tjetër (edhe një tjetër, edhe një më shumë), is translated *another* (another one), that is, **një tjetër të ndryshëm**, or *one more*. Below are some examples:

Unë do të marr një libër tjetër. (Different from the first one).	<i>I shall take another book.</i>
Unë do të vij një ditë tjetër. (Different from this day).	<i>I shall come another day.</i>
Do të marr edhe një libër tjetër. (A book added to the taken one).	<i>I shall take one more book.</i>

If **tjetër** is used to show the repetition of the action, which may be expressed by the following words, as **përsëri**, **prapë**, **shumë më tepër**, then, in English it should be translated **more**.

A do të dëshironi edhe një çaj tjetër?	<i>Will you have some more tea?</i>
Unë do të blej edhe dy libra të tjerë.	<i>I shall buy two more books.</i>

Tjetër and **tjetri** mean also *next* and/or *the next*. It shows another event or action, as in these examples: **Hërën tjetër** - *Next time*; **Pika tjetër e programit** - *Next item of the program*, etc.

Table no. 72 (The declension of indefinite pronoun (një) tjetër)

Case	Masculine		Feminine	
	Singular	Plural	Singular	Plural
Nominative	një tjetër	të tjerë	një tjetër	të tjera
Genitive	i (e) një tjetri	i (e) të tjerëve	i (e) një tjetre	i (e) të tjerave
Dative	një tjetri	të tjerëve	një tjetre	të tjerave
Accusative	një tjetër	të tjerë	një tjetër	të tjera
Ablative	prej një tjetri	prej të tjerëve	prej një tjetre	prej të tjerave

Tjetër (*else*) is used with interrogative pronouns:

Kush ërdhi tjetër?	<i>Who else came?</i>
Çfarë tha ai tjetër? or Çfarë tjetër tha ai?	<i>What else did he say?</i>
Kush tjetër ishte duke lexuar?	<i>Who else was reading?</i>

I njëjti, e njëjta, të njëjtit, të njëjtat (*same*)

I njëjti, e njëjta, të njëjtit, të njëjtat (*the same*), mean **po ai, po ajo, po atë, po ata, po ato**. Examples:

Ai qëndroi në të njëjtin (në po atë) hotel.

He stayed at the same hotel.

Unë banoj në të njëjtën (në po atë) shtëpi sikursé (sikundër) edhe vëllai im.

I live in the same house as my brother.

The reflexive pronoun - Unë vetë (I myself) - again

Unë vetë (*I myself*) is a reflexive pronoun. See the following sentences:

	Unë vetë e pashë atë.	<i>I saw it myself.</i>
or	Unë e pashë vetë atë.	<i>I myself saw it.</i>
or	Unë e pashë atë vetë.	<i>I myself saw it.</i>

If **vetë** is used to mean **madjë édhe** is translated *even, own*. Examples:

Madjë édhe vetë i ati i tij nuk e dinte.	<i>Even his father did not know it.</i>
Edhe vetë i ati i tij nuk e dinte, madjë.	<i>Even his father did not know it.</i>
Édhe i ati i vetë nuk e dinte atë.	<i>His own father did not know it.</i>
Vetë i ati i tij nuk e dinte.	<i>His father himself did not know it.</i>

Finally, **po ai**, means **pikërisht ai**, **pikërisht ajo**, **pikërisht atë**. It is translated *very and* should be followed by a noun. Examples:

Po atë ditë	<i>That very day.</i>
Pikërisht atë ditë.	<i>That very day.</i>



Conversation (Track 49)

Iliri:	A ka ndonjë mesazh për mua? ¹⁾
Doroti:	Oh, po! Znj. Prifti telefonoi. Fëmija e saj është përsëri e sëmurë.
Iliri:	Oh, Zot i madh!
Doroti:	A mund t'i bësh vizitë sonte? ²⁾
Iliri:	Po, kështu mendoj. A telefonoi dikush tjetër?
Doroti:	Mendoj se ishte dikush tjetër - taní, kush ishte ai? Petrít, ti u përgjigje në telefon: kush telefonoi tjetër përveç Znj. Prifti?
Petríti:	Oh, ishte rrobaqepësi për të thënë se kostumi juaj tjetër i ri ishte gati për provë.
Iliri:	Oh, mirë! Epë, do të bëja mirë të zbrisja atë taní. Por nuk më pëlqen të shkoj në qytet me veturë vetëm me një qëllim. ³⁾ Do të parapëlqëja të bëja diçka tjetër në të njëjtën kohë. A nuk ka ndonjë gjë tjetër që dëshironi të dyqanet?
Doroti:	Oh po, gjithnjë ka diçka tjetër që unë dua të dyqanet. Kam një kek për çajin ..., çfarë tjetër do të dëshironit?
Petríti:	Unë do të dója ca mjaltë.
Doroti:	Oh, kjo është një ide e mirë. Nuk kam fare mjaltë në shtëpi. Ilir, ti mund të marrësh një kavanoz nga markëti.
Iliri:	Markëti! Në rrëgull! Dhe ku duhet të shkoj gjëtkë?
Doroti:	Posi, ti mund të sjellësh nga markëti një kilogram me biftékë.

- Iliri:** Për skarë apo për të zierë?⁴⁾
Doroti: Për të zierë.
Iliri: A ka tani ndonjë gjë tjetër që doni ju ndërsa unë do të jem jashtë?⁵⁾
Doroti: Po, ne duam një ton qymyr guri.
Iliri: Mendón ti se unë do të vë një ton qymyr guri mbrapa veturës!?
Doroti: Oh, sigurisht që jo, gjëpura! Vetëm porosite!⁶⁾

Explanations: 1) A ka ndonjë mesazh (njoftim) për mua? - *Are there any messages for me?* - 2) A mund të bësh vizitë sonte? A mund të telefonosh sonte? - *Can you call this evening?* - 3) Nuk më pëlqen të shkoj në qytet me makinë vetëm me një qëllim - *I don't like driving into town with only one purpose.* - 4) Për skarë apo për të zier - *For grilling or for stewing?* - 5) A ka ndonjë gjë tjetër që doni ju ndërsa unë do të jem jashtë?; A dëshironi ndonjë gjë tjetër të sjell, ndërsa unë do të jem jashtë? - *Is there anything else you want while I'm out?* - 6) Oh, sigurisht (që) jo, gjëpura! Vetëm porosite! - *Oh, of course not, silly! Only order it!*

Reading exercises

1. **Diçka jetër, më jep mua: Më jep mua diçka tjetër:** Diçka tjetër, më jep mua: Më jep mua diçka tjetër. - Vend tjetër, ka banuar ai: A ka banuar ai në një vend tjetër? - Njeri tjetër, ai njih: Ai njih një njeri tjetër. - Njeri tjetër, ne folëm: Ne i folëm një njeriu tjetër. - Vend tjetër, ai di: Unë di një vend tjetër. - Vend tjetër, po shkojmë: A po shkojmë në një vend tjetër?

2. **Unë i pastrova vetë dritaret: Mendova se ti gjete dikë tjetër për t'i pastruar:** Unë i pastrova vetë dritaret: Mendova se ti gjete dikë tjetër për t'i pastruar. - Ai e riparoj vetë dritarën: Mendova se ai gjeti dikë tjetër për ta riparuar atë. - Ne e drejtojmë uzinën vetë: Mendova se ti gjete dikë tjetër për ta drejtuar atë. - Ata i mësojnë fëmijët vetë: Mendova se ata gjetën dikë tjetër për t'i mësuar ata. - Ajo e drejtoi vetë veturën: Mendova se ajo gjeti dikë tjetër për ta drejtuar atë.

3. **Ka: A ka ndonjë vend tjetër?:** Ka: A ka ndonjë vend tjetër? - Nuk ka, njeri: Nuk ka njeri tjetër. - Ka, diçka: Ka diçka tjetër. - Ka, ku: Ka diku tjetër. - Ka, njeri: A ka njeri tjetër? - Ka, gjë: A ka ndonjë gjë tjetër? - Nuk ka, gjë: Nuk ka gjë tjetër.

Sentences and phrases for lessons 47 and 48

Unë gjithnjë kënaqem duke dëgjuar program të mirë në radio.

I always enjoy listening to a good program on the radio.

Ti nuk ndihmón njeri duke qëndruar aty dhe duke mos bërë asgjë.

You are not helping anybody by standing there and doing nothing.

A ka ndonjëri kundërshtim po të mbyll dritaret?

Does anybody object to my shutting the windows?

Rrobat e mia për arnim janë mbi shtrat.

My clothes for mending are on the bed.

Unë kam vënë çdo gjë tjetër në hufë.

I've put everything else in the cupboard.

Drejtori dhe sekretaria e tij janë këtu, a do të vijë dikush tjetër?

The manager and his secretary are here, is anybody else coming?

Kush tjetër dëshiron t'i shikojë këto fotografi?

Who else wants to look at these photos?

Nuk më pëlqën të rri në këtë kafënë, le të shkojmë diku tjetër.

I don't like sitting in this café, let's go somewhere else.

Po, por ku tjetër mund të shkojmë?

All right, but where else can we go?

Practice exercises

1) Translate into English: 1. Më jep një gjë tjetër për të ngrënë. - 2. A nuk ka ndonjë gjë tjetër për ne për të bërë? - 3. Çfarë gjë tjetër mund të marim ne me vete? - 4. Asnjë njeri tjetër nuk mund t'ju thotë përgjigjen. - 5. Shko dhe kërko të të ndihmojë një person tjetër. - 6. A ka ndonjë person tjetër që po rri jashtë portës? - 7. A ka njerëz të tjerë që janë duke pritur? - 8. Të gjithë njerëzit e tjerë në ndërtesë kanë shkuar në shtëpi. - 9. Në ç'vend tjetër ke ndërmend të shkosh? - 10. A ka banuar ai në ndonjë vend tjetër në Shqipëri? - 11. Kujt personi tjetër i folë ti? - 12. Dikush ka nxjerrë nga kutia të gjitha sendet e mia. - 13. Nëse ndieni shumë vapë pranë zjarra uluni në ndonjë vend tjetër. - 14. Ai nuk më tha ndonjë gjë tjetër rreth udhëtimit të tij. - 15. Dëshiroj që ti të shkosh në bankë, dhe në asnjë vend tjetër.

2) Translate into Albanian: 1. There are some messages for you, on the table, near the telephone. - 2. Except for Ilir, I know many people that would like to walk just a little outside. - 3. I am afraid there is nothing else for you to see. - 4. Do you intend to go to the shops to buy cigarettes? - 5. Do you mind getting a newspaper at the same time? - 6. Don't they say anything else in their letters? - 7. Can you order some paper for your typewriter machine? There is not any paper in the cupboard. - 8. Somebody called me yesterday, was it you or someone else?

3) Translate into English: 1. Unë nuk pata gjë tjetër për të thënë, prandaj ika. - 2. Çfarë tjetër do ti që unë të shkruaj? Unë nuk kam asgjë të re për t'i thënë atij. - 3. A dëshironi gjë tjetër? Po, unë dua një kafe tjetër nëse ka ndonjë. - 4. Unë kam diçka shumë të bukur për të treguar. - 5. Përse nuk ma ke thënë më parë? Sepse unë vetë nuk e dija akoma. - 6. Ky është për ai film që pamë dje. Le të shkojmë në ndonjë vend tjetër. - 7. Kjo nuk më pëlqen. Më jep diçka tjetër. Çfarë tjetër? Çfardo tjetër. - 8. A ke nevojë për gjë tjetër? Jo, unë nuk kam nevojë për gjë tjetër. - 9. Faleminderit. - 10. Jo të gjithëve u pëlqen ajo gjë, apo ajo? - 11. Po atë ditë, erdhi një tjetër letër me lajme të mira.

Lesson 49 / Mësimi dyzet e nëntë
Forty-ninth Lesson / Mësimi i dyzetënëntë
Vocabulary / Fjalorth

amerikan, amerikane - *American*
i (e, të) dashur, i (të) këndshëm - *lovely*
i (e, të) fortë - *strong*
gosti, pritje; parti - *party*
gjatësi - *length*
gjë pa kuptim - *nonsense*
i (të) hajtëm; i (e, të) hollë - *slim*
i (e, të) përsosur - *perfect*
katror, shesh - *square*
kostum (për burra) - *suit*
kostum i qepur me porosi - *tailored suit*

modë - *fashion*
ndryshim - *difference*
në ditët e sotme - *nowadays*
ngjashmëri, ngjasim - *likeness*
pallë, rrudhë - *crease*
pantallona - *trousers*
se, sesa (for comp. degree) - *than*
shpatull, sup - *shoulder*
vesh, mbath - *(to) wear*
veshje për pritje, për mbrëmje -
a party-dress

Comparison degrees of adjectives and adverbs

Adjectives and adverbs have degrees of comparisons. The degrees are 3 (three). Comparisons implies two people or two things. This is typical for positive and comparative degrees. The degrees are as follows: a) **positive degree**, or **equal comparison**, b) **comparative degree**, or **unequal comparison** and c) **superlative degree**.

Positive degree

This degree has two special phrases of comparisons. They are: **po ashtu ... si** (*so ... as*), **po aq ... sa** (*as many ... as; as much ... as*) and **jo aq ... sa, jo ... ashtu si** (*not as many as ...; not as much as ...*), etc.

Po ashtu i mirë si ... or **po aq i mirë sa ...** (*as good ... as*) are used with adjectives. **Po aq ... sa, or si ... edhe** (*as many ... as*) are used when people or things are involved. Examples:

Ai është po aq i mirë sa (edhe) ti.
He is as good as you.
Ai nuk është po aq i mirë sa (edhe) ti.
He is not as good as you.
Unë kam aq shokë sa (edhe) ti.
I have as many friends as you.
Ai nuk është po aq i mirë sa (edhe) ti.
He is not so good as you.
Unë nuk flas shqip aq mirë sa ajo
I don't speak Albanian as well as she does.

Augmentative degree

The augmentative, or otherwise the unequal comparison degree, is used for adjectives and

adverbs. This has two parts.

Part one: is formed by putting the particle **më** (-er, more) before the adjectives and adverbs, as follows: **i madh** (great, big) - **më i madh** (greater, bigger). Examples:

Positive

i madh - great, big
i thellë - deep, profound
i mërzitur - sad
i lumtur - happy
i gjerë - wide, broad
i bukur - nice, beautiful
i përsosur - perfect

Comparative

më i madh - greater, bigger
më i thellë - deeper, more profound
më i mërzitur - sadder
më i lumtur - happier
më i gjerë - wider, broader
më i bukur - nicer, more beautiful
më i përsosur - more perfect

Part two: is preceded by **se**, or **sesa** (than), followed by other parts of the speech, as in **i madh** (great, big) - **më i madh se**, or **më i madh sesa** (greater than, bigger than), etc. Examples:

Aí është më i gjatë se ti.

He is taller than you.

Aí është më inteligjént sesa mendón ti.

He is more intelligent than you think.

With personal pronouns, the second part of the comparison, should respond to the first one. Therefore, if the first part of the comparison has the value of the subject, the second part will use the subjective form of the pronoun. Example:

Aí është më i gjatë se unë.

He is taller than I.

Ajó është më e gjatë se ajo.

She is taller than her.

To compare two adjectives which are connected by the same subject, use **më** (-er, more). The comparative phrase **më shumë se** (sesa), **më tepër se** (sesa), is translated *more than*.

Aí është më i hajtëm se i gjatë.

He is more slim than tall.

Diminutive degree

This comparison is made by using **më pak** (less), followed by the second part of comparison **se**, **sesa** (than): **më pak se** (sesa) - *less than*. Examples:

Aí është më pak i gjatë sesa unë.

He is less tall than I (or than me).

Ajó është më pak interesante sesa e mendóva unë.

It is less interesting than I thought.

Lesson 49 / Mësimi dyzet e nëntë

Më pak se, më pak sesa, will be translated *less than*, if the noun is in singular, and *fewer than*, if the noun is in plural. Examples:

Unë kam më pak flokë sesa ti.

I have less hair than you.

Unë kam më pak shokë sesa ti.

I have fewer friends than you.

Superlative degree

This degree compares more than two people or more than two things. For this use **shumë** (*very much*), **fort** (*very much*), **tepër** (*quite*), **mjaft** (*enough*), etc., before the adjectives or adverbs, like: **shumë i mirë**, **shumë i keq** or **mjaft i mirë**, **mjaft i keq** (adjectives); **shumë mirë**, **shumë keq** or **mjaft mirë**, **mjaft keq** (adverbs). This comparison does respond to the English superlative degree with *most* or *-est*, accordingly. Examples:

Comparative

më i madh - *greater, bigger*

më i thellë - *deeper, profounder*

më i mërzhitur - *sadder*

më i lumtur - *happier*

më i gjërë - *wider, broader*

më i bukur - *nicer, more beautiful*

më i përsosur - *more perfect*

Superlative

shumë i madh - *greatest, biggest*

tepër i thellë - *deepest, most profound*

mjaft i mërzhitur - *saddest*

tëjet i lumtur - *happiest*

shumë i gjërë - *widest, broadest*

tepër i bukur - *nicest, most beautiful*

mjaft i përsosur - *most perfect*

Absolute superlative degree

This degree is used to show that the comparison of things of the same group is at the highest level. For this comparison is used the particle **më** and then the adjective in definite form, like: **më i miri** (*the best*), **më i gjati** (*the longest*), **më punëtori** (*the most hard working one*), **më i vogli** (*the smallest*), **më besniku** (*the most faithful*), etc. After the adjective, to end the sentence add one of these prepositions: **prej** (*of*), **nga** (*of*), **midis** (*among*), **në** (*in*), etc. Examples:

Comparative

Cili është më i nxehhtë nga të dy vëndet? Egjipti apo Nigería?

Which is the warmer of the two countries? Egypt or Nigeria?

Superlative

Cili është më i nxehhti nga të tre vëndet? Egjipti, Nigería apo Shqipëria?

Which is the warmest of the three countries? Egypt, Nigeria or Albania?

Absolute superlative degree

Ai është më i gjati prej vëllëzërve.

He is the tallest of the brothers.

Lesson 49 / Mësimi dyzet e nëntë

More examples on absolute superlative: **më i, më e, nga, midis**

Enida ishte më e mira nga të gjitha shoqet e saja.

Enida was the best of all her friends.

Lorina është më e bukura nga të gjitha shoqet e saja.

Lorina is the most beautiful of all her friends.

Ai është më inteligjenti midis shokëve të mi.

He is the most intelligent among my friends.

The absolute superlative degree of the diminutive comparison is made by means of **më pak i ... , më pak e ... , më pak ...**, which are translated *the least ... of*. Examples:

Ai është më pak i pasuri nga shokët e mi. *He is the least rich of my friends.*

(concerning wealth, he is the last one, he is less rich than others).

If the second part of the superlative degree is a noun, real or imagined, then use the preposition **në** (*in*). Example:

Ai është njeriu më i pasur në botë.

He is the richest man in the world.

If you want to compare members of one family (brothers or sisters), use **më i madh** (*the elder*), and **më i madhi** (*the eldest*). Examples:

Ai është vëllai im më i madh.

He is my elder brother.

Më i madhi vëlla imi është mësues.

My eldest brother is a teacher.

See below the table of the comparative degrees of some adjectives and adverbs:

Table no. 73 (*Comparison of adjectives*)

No.	Positive	Comparative	Superlative degree
1	i mirë - good	më i mirë - better	më i miri (nga, prej) - (the) best
2	i keq - bad	më i keq - worse	më i keqi (nga, prej) - (the) worst
3	i vogël - little	më i vogël - smaller	më i vogli (nga, prej) - (the) smallest
4	shumë - much	më shumë - more	shumë më tepër (nga, prej) - (the) most
5	shumë - many	më shumë - more	shumë më tepër (nga, prej) - (the) most

Table no. 74 (Comparison of adverbs)

No.	Positive	Comparative	Superlative degree
1	mirë - well	më mirë - better	shumë mirë (nga, prej) - (the) best
2	keq - ill	më keq - worse	shumë keq (nga, prej) - (the) worst
3	pak - little	më pak - less	shumë pak (nga, prej) - (the) least
4	larg - far	më larg - farther	shumë larg (nga, prej) - (the) farthest

Gjithnjë e më shumë - more and more; **gjithnjë e më pak** - less and less

Gjithnjë e më shumë, gjithnjë e më pak, if followed by an adjective, are translated in this way:

Po bën gjithnjë e më ftohtë.

Po bën ftohtë e më ftohtë.

It's getting colder and colder.

Ajo duket gjithnjë e më e bukur.

She seems more and more beautiful.

Ajo duket gjithnjë e më pak e bukur.

She seems less and less beautiful.

The comparative phrase **sa më shumë që ... aq më**, and **sa më pak që ... aq më**, if followed by an augmentative or diminutive comparison, should be translated *the more ... the more ... (or the less)*. Examples:

Sa më shumë që studioni, aq më shumë mësoni.

The more you study the more you learn.

Sa më pak që lexon, aq më pak i mban mend fjalët e reja.

The less you read the fewer the new words you can remember.

Sa më shumë që... aq (*the more ... the more*), is another comparative phrase used in comparative degree. See the following examples: **Sa më shumë që studion, aq më shumë mëson** (*The more you study the more you learn*). In this case **sa ... aq** is not used. Example:

Sa më shumë që mplaket, aq më i padurueshëm bëhet.

The older he grows the more impatient he becomes.

Mirë ... e më mirë (*better and better*), **shumë ... e më shumë** (*more and more*), is used to show continuous changes. Examples:

Shitjet tona po shkojnë mirë e më mirë.

Our sales are getting better and better.

Vizitat e tij po bëhen shumë e më shumë të shpeshta.

His visits are growing more and more frequent.

Adverbs of manner

The adverbs are characterized by two special features:

1) The most common way is by adding the **-isht** ending, which responds to **-ly**. **I qetë - qetësisht, i mirë - mirësisht, i plotë - plotësisht, i gjerë - gjerësisht**, etc. **Lirisht** (*freely*), **gjerësisht** (*broadly*), **rregullisht** (*regularly*), **natyrisht** (*naturally*) are adverbs.

2) The majority of the adjectives have the comparative and superlative degrees.

The comparative degree is formed by putting **më** (*more*) before them; the superlative degree is formed by using **shumë, tepër, mjaft, fort, krejt, fare, bukur** just before the adverbs which are translated (*the*) *most*. Examples:

mirë	më mirë	shumë (tepër) mirë
bukur	më bukur	shumë (tepër) bukur
shpejt	më shpejt	shumë (tepër) shpejt
keq	më keq	shumë (tepër) keq
lirisht	më lirisht	shumë (tepër) lirisht
gjerësisht	më gjerësisht	shumë (tepër) gjerësisht
natyrisht	më natyrisht	shumë (tepër) natyrisht
rregullisht	më rregullisht	shumë (tepër) rregullisht

See the use of the particle **më** after the adverb **shumë**: **Ai erdhi shumë më shpejt se ç'pritej** (*He came much earlier than he was expected to*). You are advised not to use the accusative case to make sentences with **se, sesa** (*than*). Examples:

Ai vjen në zyrë më rregullisht se unë.

He comes to the office more regularly than I do.

Ai vrapoi më shpejt sesa polici.

He ran more quickly than the policeman (did).

I ngjashëm (like, alike) and **i ndryshëm** (unlike, different)

To compare people or things, you need say that a thing, or a person is like, alike, or different from other people or things. **I ngjashëm si**, is translated *like*. **I ngjashëm**, is an adjective, **si** is a preposition. **I ndryshëm nga, ndryshe prej** (*different from*), are followed by an adjective and a preposition. **Ndryshe nga, i ngjashëm si unë**, require the nominative case **ndryshe prej, i ngjashëm prej meje**, require the accusative case. Examples:

Lesson 49 / Mësimi dyzet e nëntë

Petriti	i ngjan	nënës së tij.
<i>Petrit is</i>	<i>like</i>	<i>his mother.</i>
Vetura juaj është	e ndryshme	nga e jona.
<i>Your car is</i>	<i>different</i>	<i>from ours.</i>
Ai është ndryshe nga unë.		<i>He is different from me.</i>
Ai ndryshon shumë nga unë.		<i>He is quite different from me.</i>
Ajo është e ngjashme me mua.		<i>She is like me.</i>
Ti je shumë si unë.		<i>You are very much like me.</i>

Nouns that have connection with **i ngjashëm** (*like*), and **i ndryshëm**, **ndryshe** (*different*), are **ngjashmëri** (*likeness*) and **ndryshim** (*difference*). Examples:

Midis dy motrave ka një ngjashmëri të madhe.
There is a strong likeness between the two sisters.
Cili është ndryshimi midis një nëpunësi dhe një arkëtari?
What is the difference between a clerk and a cashier?

The adjectives **i ngjashëm**, **e ngjashme**, **të ngjashëm**, are translated *alike*. These are used after the nouns, but never before them. Example:

Të gjitha veturat në fabrikë janë të ngjashme.
All the cars in the factory are alike.

Një, tjetër (one) and të tjerë (ones)

To avoid the repetition of a noun in a sentence, use **një** (*singular*), and **të tjerë** (*plural*), which are translated respectively *one* and *ones*. Examples:

1. **Mua nuk më pëlqen ai fund.**
2. **Më jep një fund më të gjatë.**
3. **Po, ky fund është shumë i bukur.**
4. **Por fundet e gjelbra te vetrina, janë edhe më të bukur.**
5. **Unë do të provoj disa funde të ndryshëm.**

Now look at the English translation of the above mentioned patterns with **një** (*one*), **një tjetër** (*one*), **të tjerë** (*others*):

- | | |
|--|--|
| 1. Mua nuk më pëlqen ai fund. | <i>I don't like that skirt.</i> |
| 2. Më jep një (tjetër) më të gjatë. | <i>Give me a longer one.</i> |
| 3. Po, ky tjetri është mjaft i bukur. | <i>Yes, this one is quite nice.</i> |
| 4. Por të tjerët të gjelbër në vetrinë janë edhe më të bukur. | <i>But the green ones in the window are still nicer.</i> |

5. Do të provoj disa të tjerë
të ndryshëm.

*I will try several different
ones.*



Conversation (Track 50)

- Elsa: Ti je grúaaja më e sjëllshme që unë njoh, Znj. Bégu!
- Doroti: Oh, gjépura! ¹⁾
- Elsa: Po, po, dhe ky është fustani më i búkur mbrëmjeje, që unë kam parë ndonjëherë.
- Doroti: Ti nuk je aq e gjatë sa unë; ndóshta ai mund të jëtë tépër i gjatë për ty.
- Elsa: Jo, më rri në mënyrë të përsosur. ²⁾
- Doroti: Më lër të shoh. Po, dúket shumë i búkur. E kanë bërë për mua ³⁾ pësë vite më parë. Mbasë atëherë ísha më e hajthme sesa jam taní.
- Elsa: Më pëlqéjnë këto fúnde. Më rrinë më mirë sesa të shkúrtrit.
- Doroti: Mendój se këto díte móda për grátë në një vend është shumë e ngjashme me atë të véndeve të tjéra.
- Elsa: Po. Ka një ndryshím të vógël. Mendój se fémrat shqiptáre véshin fúnde me kuadráte apó të qépur më shpesh sesa véshim ne.
- Doroti: Sigurísht, móda e búrrave túaj është e ndryshme nga jóna. Súpet e xhakétave janë më shumë katróre, dhe ató nuk príten në të njëjtën mënyrë. Oh po, ka ndryshíme të vógla. Por atá të gjithë véshin pantallóna me palë para dhe prápa, dhe të gjithë véshin xhakéta dhe kémísha, e kraváta.
- Doroti: Askúsh tjetër nuk vë kravátë pikërisht si ató amerikánet. ⁴⁾
- Elsa: Oh, disa nga të rinjtë në vëndin tim i vënë!
- Doroti: Mirë e dashur, mendój se sonte do të dúkesh shumë e búkur.
- Elsa: Të falemindérit shumë që po më húan fustánin, Znj. Bégu.

Explanations: 1) Gjepura; gjë e pa kuptimtë; budallallëqe - *nonsense*. - 2) më rri në mënyrë të përsosur; më rri shumë mirë - *It fits me perfectly*. - 3) e kanë bërë për mua; e kam bërë te rrobaqepësi për veten time - *I had it made for me*. - 4) pikërisht si ato (kravatat) amerikane - *quite like the American ones*. - 5) Disa të rinj në vëndin tim; disa nga të rinjtë në vëndin tim i vënë - *some of the younger men in my country do*.

Reading exercises

1. I gjatë, Iliri, Ladi, Xhorxhi: Iliri është i gjatë, por Ladi është më i gjatë; dhe Xhorxhi është më i gjati nga të gjithë: I gjatë, Iliri, Ladi, Xhorxhi: Iliri është i gjatë, por Ladi është më i gjatë; dhe Xhorxhi është më i gjati nga të gjithë. - E hajthme, Helena, Doroti, Elsa: Helena është e hajthme, por Doroti është më e hajthme; dhe Helena është më e hajthmja nga të gjitha. - Shtëpia jonë, shtëpia e tij, shtëpia e Xhorxhit: Shtëpia jonë është e madhe, por shtëpia e tij është më e madhe, dhe ajo e Xhorxhit është më madhja nga të gjitha. - Shpejt, autobusi, treni.

një aeroplan: Autobusi është i shpejtë, por treni është më i shpejtë; dhe aeroplani është më i shpejti nga të gjithë. - I vjetër, ky dyqan, ai pub, kisha: Ky dyqan është i vjetër, por ai pub është më i vjetër; dhe kisha është më e vjetra nga të gjitha.

2. Elsa është më e hajthme sesa Helena. Kështu, Helena nuk është po aq e hajthme sa Elsa. Jo, Elsa është më e shëndosha: Elsa është më e hajthme sesa Helena. Kështu, Helena nuk është po aq e hajthme sa Elsa. Jo, Elsa është më e shëndosha. - Xhorxhi është më i gjatë sesa Iliri. Kështu, Iliri nuk është po aq i gjatë sa Xhorxhi. Jo, Iliri është më i shkurtri. - Xhoni është më i vjetër sesa Petriti. Kështu, Petriti nuk është po aq i vjetër sa Xhoni. Jo, Petriti është më i ri. - Qumështi është më i mirë sesa uji. Kështu uji nuk është po aq i mirë sesa qumështi. Jo, qumështi është më i keq. - Dreka është më herët sesa darka. Kështu darka nuk është po aq herët sa dreka. Jo, darka është më e vona.

3. Vij, rregullisht, grua: Ai vjen më rregullisht sesa gruaja e tij: Vij, rregullisht, grua: Ai vjen më rregullisht sesa gruaja e tij. - Mendoj, shpejt, mësues: Ai mendon më shpejt sesa mësuesi i tij. - Punoj, ngadalë, atë: Ai punon më ngadalë sesa i ati. - Flas, lehtë, motër: Ai flet më lehtë sesa motra e tij.

Practice exercises

1) Translate into English: 1. Ajo është më e re se i vëllai. - 2. Kjo karrige është më e rehatshme se ajo atje. - 3. A mund të shkojmë në një vend më të qetë? - 4. Ai nuk ishte aq i lodhur sa unë. - 5. Ti je vërtet tipi më i padurueshëm që unë njoh. - 6. A mund të jesh pak më i vëmendshëm? - 7. Unë besoj se ky është treni më i ngadalshëm në botë. - 8. Nuk ndiej të kem po aq uri sa dhjetë minuta më parë. - 9. Zyra jonë është po aq moderne sa edhe juaja, ajo është shumë më komode. 10. Kjo është një nga pyetjet më interesante dhe serioze që mund të bësh.

2) Translate into Albanian: 1. She speaks Albanian much better than one year ago. - 2. Please, make less noise. - 3. Our house is farther from the station than your house. - 4. I have never seen such a bad example as that one. - 5. Please, do not talk so harshly to my dog. - 6. She struggled to hear what they were talking about. - 7. You should go abroad more often and learn more foreign languages. - 8. I have studied this problem as completely as you have. - 9. We saw that the poorer people were more polite. - 10. His name is a well-known one, it is much more known than mine.

Lesson 50 / Mësimi pesëdhjetë
Fiftieth Lesson / Mësimi i pesëdhjetë
Vocabulary / Fjalorth

akull - ice
 apartament - flat
 i (e, të) rrafshhtë, i (e, të) shështë - flat
 lë, lëshoj, vë poshtë, ul - (to) put down
 parapëlqej më tepër (më shumë)
 - I would rather prefer
 fluturój - (to) fly

i (e, të) përgjumur - sleepy
 i (e, të) rëndë - heavy
 mizë - fly
 parapëlqej - (to) prefer
 pjatë - plate
 përmirësój, bëj më mirë - (to) get better

Mjaft (enough) and shumë tepër (too much)

Mjaft and **tëpër** (enough, too much and/or quite) are used before the noun to mean **sa duhet**, that is, *enough* or *as much as necessary*. Example:

Ne kemi mjaft bukë.

We have enough bread.

In some cases, they may also be found before certain adjectives or adverbs. Examples

Uji është mjaft nxehët.

The water is hot enough.

Ai është tepër i mirë.

He is quite good.

Ajo është një mësuese mjaft e mirë.

She is quite a good teacher.

Ai është shumë mirë.

He is quite well.

Tepër, and **më shumë sesa duhet**, in the meaning *more than it is necessary* are translated *too* and *too much*.

Tepër (*too*), and **shumë, tepër** (*too much*) are used before the adjectives and adverbs. follows:

Ti je shumë dembël.

You are too lazy.

Ti je shumë i dembelósur.

You are much too lazy.

Është tepër vonë.

It is too late.

Tepër shumë, or **shumë, shumë** (*too much, too many*), are used before nouns, as in the following examples:

Ti ke pirë shumë tepër qumësht.

You have taken too much milk.

Këtu ka shumë, shumë miza.

There are too many flies, here.

Tepër (*too*), **tepër shumë**, **shumë tepër** or **shumë, shumë** (*too much, too many*), may be intensified by such phrases as: **më shumë se ç'duhet**, **më tepër se ç'duhet**, **tej masës**, which are translated *far*. Examples:

Ti ke pírë qumësht më shumë se ç'duhet.

You have taken far too much milk.

Kjo është tej mäsës e mirë.

It's far too good.

Uji është tej mäsës i ngrohtë.

The water is much too hot.

Tepër and **mjaft**, are followed by another prepositional phrase **për** (*for*).

Tepër (*too*) and **mjaft** (*enough*), if followed by the preposition **për** (*for*), end with nouns in accusative case, for example, **për duart e mia**, **për ty**, etc. Examples:

Ka mjaft bukë për dhjetë njerëz.

There is enough bread for ten people.

Uji është tepër i nxhtë për duart e mia.

The water is far too hot for my hands.

Ata gurë janë tepër të rëndë për ty.

Those stones are too heavy for you.

Mjaft, if it means **aq sa duhet** is followed by a sentence with a verb in subjunctive mood. In this case it shows result, or purpose. Examples:

Ai nuk vrapoi aq shpejt sa duhej që të kapte trenin.

He didn't run quickly enough to catch the train.

Ne kemi mjaft para që të na mbajnë për një vit.

We have enough money to keep us for a year.

Ky ujë është tepër i ndotur për ta përdorur.

This water is too dirty to use.

Aq, kaq (so, such)

Aq, kaq are translated *so*. **Aq** and **kaq** are followed by **saqë** (*that*) in a expanded clause, and by **sa** (*as*) in an un-expanded one. Examples:

Unë isha aq i lodhur saqë shkova menjëherë për të fjetur.

I was so tired that I went to sleep at once.

Unë isha kaq i lodhur saqë dëshiroja të flija menjëherë.

I was so tired so that I wanted to sleep at once.

If **kaq** is followed by a singular adjective, or if it is between the noun and the adjective, it may be translated in two ways: *so*, or *such*.

If using **aq** or **kaq** (*so*), start the sentence with a noun, and later use **aq** or **kaq** and finally place the adjective, as in this sentence:

Njeri aq i pasur or Njeri kaq i pasur. *So rich a man.*

I tillë, e tillë, të tillë; i këtillë, e këtillë, të këtillë, kaq - such, such as, as such.

When using these, start the sentence with a noun, and later place the right adjective

Examples:

Njeri i tillë i pasur or Njeri kaq i pasur. *Such a rich man.*

Nuk kam parë kurrë të tillë njeri. *I have never seen such a person.*

Nuk kam parë kurrë të tillë njerëz. *I have never seen such people.*

Nuk kam parë të këtillë njeri. *I have never seen such a person.*

Nuk kam parë të këtillë njerëz. *I have never seen such people.*

I tillë njeri është ai. *He is such a person.*

If the noun is plural, you may use either **aq** (*such*), or **kaq** (*so*), as in:

Njerëz aq të pasur. *Such rich men.*

Njerëz kaq të pasur. *Men so rich.*



Conversation (Track 51)

Iliri: Çfarë do të pëlqënit të bëni këtë mbrëmje, Xhon?

Xhoni: A e di, sonte është kaq ngrohtë saqë unë nuk ndiej se mund të bëj ndonjë gjë.¹⁾ A nuk të duket kjo sikur unë të isha dembel. Jam aq rehat saqë përtoj të lëviz.

Iliri: Po, edhe unë ndihem pikërisht si ti! Por le të ulemi në kopsht. Atje nuk ka shumë miza, dhe do të jete më frëskët sesa në shtëpi.

Helena: A ta sjell radion aty jashtë? Dhe kjo është karrigia.

Xhoni: Oh, jo, ma lër mua ta bëj këtë.²⁾ Ajó është tepër e rëndë për ty për ta mbajtur.

Iliri: Unë do t'ju ndihmój Xhon. Mendój se kjo qóshe e kópshtit është mjaft e sheshtë për karríget që të qëndrojnë drejt.³⁾

Xhoni: Oh, sa bukur që është këtë! E di, ne jemi kënaqur kaq shumë duke qëndruar me ju, saqë nuk dëshirojmë të shkójmë në shtëpi.⁴⁾

Iliri: Ka qënë gjë e bukur që ju kemi patur këtë. Kam vënë ca bírra në akull dhe së shpéjti do të ftohen më shumë se ç'dúhet që të pihen. Helénë, mendój që ti më mirë të píje limonádë. Do të shkoj brénda dhe të sjell píjet për një minutë.

Petriti: A t'i marr unë nëse ti ndíhesh shumë i përgjómur?

Iliri: Znj. Bégu do të kthéhet së shpéjti. Shpresój që ajó të mos jete shumë e lódhur mbas vizítes në spítal.

Petriti: Ajó telefonói paksa më parë.⁵⁾ Motra e saj Zana, po përmirësóhet me shpejtësi.⁶⁾ Ajó shpejt do të bëhet mjaft mirë për t'u ngrítur.

Helena: Oh, jam kaq e gëzuar! ⁷⁾

Explanations: 1) nuk ndiej se mund të bëj ndonjë gjë; nuk më bëhet të bëj asgjë; nuk më vjen të bëj asgjë; nuk ndihem mirë për të bërë ndonjë gjë - *I don't feel like doing anything.* - 2) ma lër mua ta bëj këtë; lërmë ta bëj unë - *let me do that.* - 3) është mjaft (tepër) i sheshtë për karriget që të qëndrojnë drejt - *is flat enough for the chairs to stand up all right.* - 4) saqë nuk na shkohet në shtëpi; saqë nuk duam të shkojmë në shtëpi - *we don't want to go home.* - 5) pak më herët; paksa më herët; një çikë më herët - *a bit earlier.* - 6) po bëhet më mirë me shpejtësi; po përmirësohet me të shpejtë - *is getting better quickly.* - 7) Jam kaq e gëzuar; Sa më bëhet qejfi; Sa e gëzuar që jam - *I'm so glad.*

Reading exercises

1. **I lodhur, flë:** Unë qeshë aq i lodhur saqë fjeta shumë gjatë: I lodhur, flë: Unë qeshë aq i lodhur saqë fjeta shumë gjatë. - I uritur, ha: Unë qeshë aq i uritur saqë hëngra shumë ushqim. - I etur, pi: Unë qeshë aq i etur saqë piva shumë ujë. - Vonë, vrapoj: Unë qeshë aq vonë, saqë vrapova shumë shpejt. - I mençur, shkruaj: Unë qeshë aq i mençur saqë shkrova shumë letra.

2. **Ti nuk ke pirë mjaft qumësht. Po, unë kam pirë shumë:** Ti nuk ke pirë mjaft qumësht. Po, unë kam pirë shumë. - A je i sigurt se ke marrë mjaft sheqer? - Po, kam marrë shumë. - A ju dhashë të hani mjaft ushqim? Po, ju më dhatë shumë ushqim. - A ke mjaft bukë? Po, kam shumë bukë. - A ke marrë shumë gjalpë? Po, kam marrë shumë gjalpë.

3. **Mësim i vështirë, kuptoj: Ky është kaq mësim i vështirë, saqë unë nuk e kuptoj. Është tepër i vështirë që të kuptohet:** Mësim i vështirë, kuptoj: Ky është kaq mësim i vështirë, saqë unë nuk e kuptoj. Është tepër i vështirë që të kuptohet. - Këmishë e pistë, laj: Është kaq këmishë e pistë, saqë unë nuk mund ta laj. Ajo është tepër e pistë që të lahet. - Gur i madh, lëviz: Ai është kaq gur i madh, saqë unë nuk mund ta lëviz. Ai është tepër i madh që të lëvizë. - Gjë e vogël, shikoj: Ajo është kaq gjë e vogël, saqë unë nuk mund ta shikoj. Ajo është tepër e vogël që të shihet. - Veturë e vjetër, ndez: Ajo është veturë aq e vjetër, saqë unë nuk mund ta ndez. Ajo është tepër e vjetër që të ndizet.

Sentences and phrases for lessons 49 and 50

Mëri është gruaja më shtatlartë që kam parë ndonjëherë.

Mary is the tallest woman I have ever seen.

Oh, jo! Margarita është shumë më shtatlartë se ajo.

Ah, no! Margaret is much taller than her.

Do të bëje mirë të mbash valixhen time, nuk është aq e rëndë sa jótja.

You'd better carry my suitcase, it isn't as heavy as yours.

Ndóshta nuk është shumë e rëndë për mua.

Perhaps it isn't too heavy for me.

Koha është mjaft e ngrohtë për të ndénjur në kopsht.

The weather is warm enough to sit in the garden.

Në fakt, është më ngrohtë sot sesa ka qënë në mes të korrikut.

In fact, it's warmer today than it was in the middle of July.

Të lutem, mos më jep më për të pírë.

Please, don't give me any more to drink.

Tashmë unë kam pírë tej masës.

I've drunk far too much already.

Cila është më e madhe nga këtë dy shtëpi?

Which is bigger of these two houses?

Unë mendoj se e jona është shtëpia më e madhe në këtë rrugë.

I think ours is the biggest house in this street.

Practice exercises

1) Make sentences using **tepër** (too), instead of **shumë**. This is the pattern: *Ky mësim është shumë i vështirë: Unë nuk mund ta kuptoj*, should be made like this: *Ky mësim është tepër i vështirë për mua për ta kuptuar*. - 1. *Kjo xhakëtë është shumë e vogël, ai është njeri aq i madh*. - 2. *Ajo është shumë budallage; ajo nuk të kupton*. - 3. *Unë jam shumë i lodhur; unë nuk mund t'i ngjitem një kodre kaq të lartë*. - 4. *Është shumë larg (use far); ne nuk mund të shkojmë atje këtë mbrëmje*. - 5. *Ai mbërriti shumë vonë; mbledhja ka përfunduar*. - 6. *Libri është shumë interesant, një njeri nuk mund ta heqë nga dora*. - 7. *Unë jam shumë i zënë, nuk mund t'ju ndihmoj*. - 8. *Ai tha se ajo ishte shumë e shtrenjtë; ai nuk mund ta blinte*. - 9. *Ishte shumë errët; një njeri nuk mund të shihte rrugën*. - 10. *Ti je shumë i padurueshëm; ne kemi nevojë për një njeri të durueshëm për këtë punë*.

2) Make sentences using **mjaft** (enough). This is the pattern: *Ai qe me shumë fat: ai pa menaxherin*, should be made like this: *Ai ishte me mjaft fat që pa menaxherin*. - 1. *Ata janë ... të pasur: ata kanë katër vetura*. - 2. *Nuk ka ... dritë, ne nuk mund të lexojmë tashmë*. - 3. *Kjo karrige është ... e rehatshme: Unë do të ulem në të*. - 4. *Ai nuk është ... i vjetër: Atij nuk i kujtohet lufta*. - 5. *A ka ai ... parë? A mund të paguajë ai për hiletën?* - 6. *Ka ... ushqim; çdo njeri mund ta hajë*.

3) Use appropriate phrases in these sentences: 1. *Çaji është aq i ftohtë ...* - 2. *Ai ishte mjaft i lodhur saqë ...* - 3. *Ajo dukej aq e zbehtë saqë ...* - 4. *Ishte një ditë kaq e bukur, saqë ...* - 5. *Ai lumë është tepër i gjerë ...* - 6. *A është ai tepër i hajthëm ...?* - 7. *Situata është aq serioze saqë ...* - 8. *Problemi ishte tepër i vështirë*. - 9. *Pati një avari aq të madhe në uzinë, saqë ...* - 10. *Ai qe aq i turpëruar që foli ashpër: saqë ...* - 11. *Ne nuk kemi mjaft parë*. - 12. *Në këtë shtëpi ka aq shkallë ...* - 13. *Ti flet aq qetë saqë ...* - 14. *Kjo është një zyrë aq moderne saqë ...*

4) Translate into English: *Këtë vit ne kemi një verë (summer) mjaft të nxehtë; shumë më të nxehtë se vitin e shkuar. Unë ndihem gjithnjë i lodhur dhe i dembelosur, aq i lodhur saqë nuk kam dëshirë të dal dhe më pëlqen të rri ulur në kopsht dhe të dëgjoj radion e të pi diçka të ftohtë. Por sa më shumë që pi, aq më shumë kam etje. Madje edhe në kopsht ajri nuk është kurrë tepër (or shumë) i freskët.*

Gjatë ditës unë shkruaj dhe lexoj, por pastaj në mbrëmje, ndihem tepër i lodhur për të bërë çfarëdo pune. Duhet të them se një verë kaq e nxehtë nuk është e këndshme. Dimri me borë dhe me të ftohtin është shumë më i mirë, por kur mund të rri në shtëpi ulur pranë një zjarri të nxehtë.

Lesson 51 / Mësimi pesëdhjetë e një
 Fifty-first Lesson / Mësimi i pesëdhjetenjë
 Vocabulary / Fjalorth

biçikletë - *bicycle*
 dëshiroj, dua; uroj - *(to) wish*
 fshat, katund - *village*
 hartë - *map*
 heq, largoj (tutje) - *(to) take away*
 kryqëzim, udhëkryq - *cross-road*
 lindje - *East*
 mes, përmes, mepërmes - *across*
 humbës; humb - *(to) lose; get lost*

i (e, të) ndërprerë; me vizë të ndërprerë
dotted (line)
 jug - *South*
 kohë (orë) e mbylljes - *closing-time*
 mbyll - *(to) close*
 shënoj, bëj shënjë - *(to) mark*
 shteg, monopat - *path*
 udhëheqës - *leader*
 urim, dëshirë - *wish*

The compound hypothetical clauses

These clauses are formed by a main clause and by a conditional subordinate one. This sentence is linked by **nëse, në qoftë se, sikur**, or by a phrase that expresses a condition, like **me kusht që ...**, and by similar phrases. There are three kinds of hypothetical clauses, which are as follows: a) **Open condition**; b) **Improbable future**; c) **Unfulfilled condition**.

a) **Open condition** is used to show a simple real condition, which may or may not be fulfilled.

Nëse ky libër është yti, përsë nuk e heq këtëj?
If this book is yours, why don't you take it away?

If the verb in a conditional clause is in future tense, then the translation must be in present tense.

Nëse do të bjerë shi, unë nuk do të dal për të shetitur.
If it rains, I wouldn't go for a walk.

b) **Improbable future** is used to show an imagined fact, which has little possibilities to be fulfilled, either in present, or in the future.

Nëse vjen ai, jepi adresën time.
(there is little possibility for him to come)
If he should come, give him my address.

The Albanian sentence may not always match with English constructions. See two following examples:

Sikur të vijë ai, jepi adresën time. *Should he come, give him my address.*

Lesson 51 / Mësimi pesëdhjetë e një

Po të vijë ai, jepi adresën time.

If he were to come, give him my address.

c) **Unfulfilled condition** is used to show a condition which is not fulfilled and may not be fulfilled. In this case, the subordinate clause is in indicative mood; the main clause is in conditional:

Sikur të kisha shumë para, do të bléja një veturë të re.

If I had a lot of money (but I don't have), I would buy a new car.

Po të kisha shkuar në mbledhje dje, do ta kisha takuar ...

If I had gone to the meeting yesterday (but I haven't gone), I would have met ...

Notes: In unfulfilled condition clauses, the imperfect of the subjunctive mood of the verb **jam (të isha)**, is translated *were* and **kam (të kisha)** is translated *had*. Example:

Po të isha i pasur do ta kisha blerë atë shtëpi.

If I were rich (but I'm not), I would have bought that house.

Po të kisha shumë para do ta kisha blerë një shtëpi.

If I had a lot of money (but I do not have), I would have bought that house.

Usages of adjectives

andej - këndej = *here and there*; **aty - këtu** = *here and there*; **poshtë e lart** = *up and down*; **rreth e qark, rreth e rreth** - *about, around, round*; **shpejt e shpejt** - *quickly, in haste*; **mirë e mirë** - *well*; **hollë - hollë** - *in detail*; **rëndë - rëndë** - *seriously*; **shumë - shumë** = *about around*.



Conversation (Track 52)

Elsa: Më lër të shoh në hartë, Petrít. Taní, nëse ti sheh me kujdës, do të kuptosh se ne jemi pikërisht - këtu.

Petríti: Jo, nuk jemi, Elsa. Jemi në qoshe.

Elsa: Më fal, Petrít, ne sapó kemi árdhur përmés atíj fshati. Taní, nëse ne do të íshim kthyer djathtas në udhëkryq, do të kishim dalë në rrugën kryesóre. Por ne nuk u kthyem,¹⁾ kështu që taní jemi duke écur ne jug në vend të línjjes.

Petríti: Mírë, ne mund të dalim prapë në rrugën kryesóre. Shíko: nëse écim një gjysmë kilométër tjetër, do të mbërríjmë tek një shteg përtéj fushave. A mund ta shóhësh atë aty, të shënuar me víza të ndërpréra?

Elsa: Oh po, e shoh.

Petríti: Në rrégull, nëse marrím atë shteg, aí do të na çójë te rruga pranë asáj birraríe.

Elsa: Birraríe! Kjo është një idé e mírë.

Petríti: Dhe në qoftë se nxítójmë, mund të arríjmë përpára orarit të mbylljes. Do të dëshirója të kishim biçíklétat.²⁾ Nëse do të kishim

biçiklétat, do të mbërrínim aty për pesë minúta.

Elsa: Mos u shqetëso! Le të vazhdojmë me shpejtësi. Unë jam e étur!

Petriti: Elsa, në qoftë se ti vjen përsëri në Shqipëri vitin tjetër, a do të vish të na takosh? Do të ishim kaq të gëzuar nëse na takón.³⁾

